

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7790 E hënë 11 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

**Jemi mësuar, por jo me ikjen e njerëzve të tillë, të dashur. Ikja e papritur e mikut tim të rinisë, Kiço Blushit ishte për mua jo vetëm e befte, por ...**

Vijon në faqen 20

Nga SULEJMAN MATO

**Kiço Blushi ishte një mik i veçantë dhe një shkrimtar i madh**



**Opinion** *i* **Ditës**

**M**e nikoqire zakonisht kuptojmë një amvisë shtëpie që terezit si duhet llogaritë e shtëpisë, por ia vlen që këtë cilësim ta përdorim edhe për përgjegjës ...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

**Një nikoqir shteti po duket... gërmadhash**



**INTERVISTA**

Flet deputeti i PD-së: Rama po tenton të luajë gurin e fundit

## Paloka: Nuk është e rëndësishme data, por vlefshmëria e zgjedhjeve

Paloka: Kemi presion nga qytetarët, duan largimin me forcë të Ramës

Nga VALENTINA MADANI

Edi Paloka, nënkryetar i PD-së dhe Kuvendit, paralajmëron kryeministrin Edi Rama se më 16 shkurt shqiptarët do të derdhen në rrugë, ndaj ai ka në dorë që të zgjedhë formën e largimit nga qeveria. "Në të kundërt - thotë Paloka ...

Në faqet 6-7

## SI DO TE PERLLOGARITET MASA QE JU TAKON TE MERRNI NE VITIN 2019, SHEMBUJT FORMULA E RE E PENSIONIT, NDRYSHIMET NE KOEFICIENTE

Ndryshon mosha e daljes në pension, sa do të jetë për 2019 e 2020. Tabelat e plota të viteve për burrat dhe gratë, kushtet e përfitimit



(Në foto) Pensionistë (Foto Ilustruese) Në faqet 8-9

**BILANCI I REFORMES**

**Krimit iu konfiskuan 21 mln euro pasuri, u shkarkuan 50 gjyqtarë e prokurorë**

Në faqen 5

**FLET GAZETARJA LALA**

**Investigimi i TV "Rai 3": Mafia, pjesë e parlamentit. Si pastrohen paratë...**

Në faqen 10

**99 VITE ME PARE**

**Nga Tirana orientale, në Tiranën evropiane, diskutimet pse u zgjodh kryeqytet**

Në faqen 11

**REPORTAZH**

**Japonia e largët gjeografikisht, por e afërt me shqiptarët**

Në faqen 18-19

**YLLI MERJA: KESHILLAT PER SPONDILARTROZEN**



**Lorela Garuli: Si të kuptoni që fëmija vuan nga çrregullimet e të nxënës në shkollë**

Suplement

Reagon edhe ministrja Etilda Gjonaj: Masa ndaj gjyqtarëve abuzues me detyrën

## Ambasadori i BE: "Dajti", vlerësim urgjent nga KLGJ

Vendimi i Apelit, Lleshaj: Nis "Forca e Ligjit", në burg gjyqtarët

**M**inistrja e Drejtësisë dhe ministri i Brendshëm e quajnë skandalozë vendimin e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për Dritan Dajtin. Në një deklaratë për mediat, ministrja Etilda Gjonaj tha se qeveria nuk synon kontrollin e drejtësisë, por se në këto raste nuk mund



të rrijë pa reaguari. Ajo paralajmëroi masa ndaj gjyqtarëve dhe tha se do t'i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas Gjonajt, vendimi i trupës së gjyqtarëve për pranimin e gjykimit të shkurtuar "për uljen e dënimit me 25 vjet për një të pandehur që ...

Në faqen 3

## PROTESTA TAKIMET

Kreu i opozitës u ndal dje në Vlorë, ku u takua me të rinj, qytetarë e biznese

# Basha: Koha për fjalë ka mbaruar, goditja finale më 16 shkurt

"Procesi politik ka marrë fund"

Vlorë ka qenë ndalesa e radhës e kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në kuadër të turit që ai ka ndërmarrë, në bazë për të ftuar qytetarët që të bëhen pjesë e protestës së datës 16 shkurt në Tiranë. I shoqëruar nga deputeti Agron Shehaj, Basha ai ka ecur në këmbë në rrugët e qytetit, ku ka takuar qytetarë të ndryshëm, duke u njohur me shqetësimet e tyre dhe vështrësitet që kanë për përbalimin e jetesës, ndërsa i ftoi që t'i bashkohen protestës së 16 shkurtit. Basha përsëriti se kjo qeveri ka ardhur në pushtet me paratë e krimit dhe nuk mendon për njerëzit. "A mund të mendojë për qytetarët, për investitorët një qeveri që ka ardhur në pushtet me paratë e krimit. Gjëja e fundit që të shkon në mendje janë hallët e njerëzve. Ardhja në pushtet e Edi Ramës është faktuar tashmë edhe nga "Zëri i Amerikës" si një grusht shteti. Ky sistem i kalbur duhet vetëm duke shembur sistemin e kalbur që e mban peng Shqipërinë. Procesi politik ka marrë fund. Koha për fjalë ka mbaruar dhe më 16 shkurt është koha për vendimarrje", - tha Basha në Vlorë. Ai theksoi se rregulli është që kur pushteti uzurpohet, janë qytetarët që e çlirojnë. Ndaj ai u bëri thirrje qytetarëve që të marrin fatin e tyre në dorë. "Zëri juaj më 16 shkurt është vullneti i sovranit. Nuk e them thjesht si kryetar i opozitës, por kam ardhur tua them si vlera e Europës ku duam të shkojmë. Më 16 shkurt t'i japim fund këtij grusht shteti. Duhet të merrni në dorë fatet tuaja. Kjo është flesa që kam për ju, për çdo vlonjate e vlonjat, për socialistët e tradhtuar dhe të



## Idrizi: PDIU me 8 mandate, por e nxorën jashtë parlamentit

Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet zhvilloi dhe mbledhjen e Forumit të Gruas, ku kryetari i saj, Shpëtim Idrizi theksoi se ky brez duhet të luftojë për t'u lënë një Shqipëri më të mirë fëmijëve, në mënyrë që ata të mos largohen nga vendi. "PDIU është një parti e pazakontë në politikën shqiptare. Ajo nuk është krijuar nga inati i dikujt, por është krijuar si parti e çështjes kombëtare shqiptare, si parti dhe amaneti i çështjes së shqiptarëve të Çamërisë. PDIU është e vetmja parti kombëtare, e vetmja parti me kauzë dhe e vetmja parti që flet dhe shtynë çdo ditë për çështjen e shqiptarëve të Çamërisë. Koha ka ndaluar për shqiptarët e Çamërisë në ditën që i kanë larguar nga trojet e tyre dhe është e njësuar me ditën që ne do të kthehemi në Çamëri, në shtëpitë tona", - tha Idrizi. Ai nënvizoi se vendit i duhen zgjedhje të reja, pasi nuk mund të qeveriset nga ata që i kanë blerë zgjedhjet. "E kam ditur se përballë kemi një shtet racist dhe një shtet me baza të errëta të neofashizmit, e kam fjalën dhe për "Agimin Artë", por nuk e kisha menduar kurrë që kundërshtarë dhe armiq do të kishim edhe politikën shqiptare. Pavarësisht se PDIU duhet të merrte 8 mandate, kjo politikë shqiptare bëri gjithçka që Çamëria të mos kishte zërin e saj në parlament. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet do të jetë partia e çdo shqiptari patriot, që e do bashkimin kombëtar dhe që e do Çamërinë", - tha Idrizi.



poshtëruar", - shtoi Basha. Ai shtoi se edhe pritshmëritë e Europës janë pikërisht të bërë ndryshimin. "Dëgjoni e mbani vesh dhe hapni

### ZGJIDHJA

"Normalisht kjo mund të zgjidhet me votë, por vota është kapur. Në Europë do ta zgjidhte prokuroria, por prokuroria është kapur. Ju e dini që ne u përpoqëm ta pastrojmë këtë sistem nga brenda me ligje me propozime, por ky sistem nuk mund të pastrohet më, ky sistem duhet përmbytur".

sytë, ky nuk është vetëm mesazhi i opozitës. Pritshmëritë e Perëndimit, Europës është tek i vetmi faktor që mund të sjellë ndryshimin dhe ky faktor jeni ju. Ne duhet ta çelim derën drejt Europës, sepse vetëm duke çelur derën drejt Europës do mund të sjellim zhvillim, punësim", - u shpreh Basha. Më tej, ai theksoi se në një vend demokratik krizat duhet t'i zgjidhte vota, por në Shqipëri kjo sipas tij nuk mund të ndodhë, pasi vota blihet nga qeveria. "Normalisht, kjo mund të zgjidhet me votë, por vota është kapur. Në Europë do ta zgjidhte prokuroria, por prokuroria është kapur. Ju e dini që ne u përpoqëm ta pastrojmë këtë sistem nga brenda me ligje me propozime, por ky sistem nuk mund të pastrohet më, ky sistem duhet përmbytur", - deklaroi Basha. Sipas kreut të opozitës, vetëm një qeveri tranzitore mund të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme që të plotësojë standardet dhe të sjellë në pushtet një alternativë që e votojnë shqiptarët dhe jo që e blen krimi dhe oligarkia. Në Vlorë ai u takua edhe me biznese e me disa maturantë, ku deklaroi se kjo opozitë do krijojë kushtet që të gjithë të rinjtë të kenë mundësi të studiojnë.



### SHKURT

## Banorët e "Astirit", në ditën e 99 të protestës, pemë për Ardit Gjoklajn

Banorët e "Astirit" kanë protestuar edhe mbrëmë kundër projektit të "Unazës së Madhe", nga i cili rrezikojnë shembjen banesat dhe pronat e tyre. Në ditën e 99 të protestës së tyre, ata kanë mbjellë pemë duke zëvendësuar kështu pemët e shkullura më parë. Pemën e parë banorët ia dedikuan Ardit Gjoklaj, 17-vjeçari që u gjet i vdekur në landfillin e Sharrës. Protestës së tyre i janë bashkuar edhe deputetët e opozitës, si të PD-së, ashtu edhe nga LSI. Deputeti demokrat, Klevis Balliu nga protesta u shpreh se kryeministri Edi Rama ka kohë deri më datë 15-shkurt që të largohet nga Shqipëria. "Kjo është arsyeja pse qytetarët janë në protestë, janë kundër kësaj monstre që i ka rrëjuar qytetarët shqiptarë. Siç thotë edhe 'Unaza', tik-tak, zoti kryeministër ke kohë deri më 15, që të largohesh nga ky vend. Në këtë vend të bekuar nga Zoti, nuk ka vend për tradhtarët. Do i bëja thirrje çdo qytetari dhe çdo efektiv të policisë për t'u ngritur kundër krim-it, kundër këlyshëve të Enver Hoxhës", u shpreh ai.

## Banorët e Zallbazarit në protestë, bashkia të mbajë premtimin për urën

Banorët e Zallbazarit protestuan dje për mungesën e një ure të premtuar prej vitesh, por ende të parealizuar. Ata qëndruan në vendin ku duhet të ishte ura, ndërsa i kërkuan Bashkisë së Tiranës që të kthejë vëmendjen nga fshati. "Siç e shikoni edhe vetë, jemi afër Bastarit të Mesëm. Një zonë tepër e prapambetur. Ura ka dy vjet që është inauguruar dhe s'kemi as urë as gjë. I bëj thirrje Veliajt të mos mbjellë as pisha, as rrape në Tiranë, por të hedhë një kokë këtej pas Dajtit, siç e shikoni zona më e prapambetur", - tha një banor. Situatën problematike e ka bërë të njohur edhe anëtarë i kryesisë së PD-së, Jamarbër Maltazi, i cili shkroi se, "edhe pse u premtua 3 vite më parë, nuk është bërë asgjë".





Reason edhe ministrja Gjonaj: Masa ndaj gjyqtarëve abuzues

# Vendimi i Apelit për Dajtin, Lleshaj: Në burg gjyqtarët

"Kemi nisur operacionin 'Forca e Ligjit' për rastin"

**M**inistria e Drejtësisë dhe ministri i Brendshëm e quajnë skandalozë vendimin e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për Dritan Dajtin. Në një deklaratë për mediat, ministrja Etilda Gjonaj tha se qeveria nuk synon kontrollin e drejtësisë, por se në këto raste nuk mund të rrijë pa reaguar. Ajo paralajmëroi masa ndaj gjyqtarëve dhe tha se do t'i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas Gjonajt, vendimi i trupës së gjyqtarëve për pranimin e gjyqimit të shkurtuar "për uljen e dënimit me 25 vjet për një të pandehur që akuzohet për vrasjen e 4 policëve tregon qartë se kemi të bëjmë me një aferë korruptive dhe në kundërshtim me kodin e procedurës penale". Ndërkaq, PD i ka quajtur "lot krokodili" reagimet e ministrave e sipas tyre me shumë vonesë.

## SKANDAL

"Prej 48 orëve kemi punuar intensivisht për të adresuar një skandal të papranueshëm të përmasave të tilla të patolerueshme të gjyqtarëve që kanë dhënë vendimin tërësisht në kundërshtim me ligjin për personin e akuzuar për vrasjen e 4 policëve. Duke ndarë me publikun revoltën legjitime të çdo qytetari përballë këtij lajmi të shëmtuar që vjen nga segmente të drejtësisë, ku ende nuk ka arritur procesi i vetingut, dua t'ju siguroj të gjithëve që jo vetëm nuk mund të pajtohem kurrë me faktin e kryer në këtë rast, por do të ndjekim të gjitha hapat me të gjitha mjetet ligjore që jeta e 4 dëshmorëve të atdheut të mos peshohet në kandin e korrupsionit, e mungesës totale të integritetit dhe profesionalizmit të disa gjyqtarëve, të cilët nuk meritojnë asgjë tjetër përveç përbuzjes së çdo qytetari të ndershëm", u shpreh Gjonaj duke shtuar se vendimi është në kundërshtim me çdo standard të procesit penal dhe rrezikon kështu të krijojë një precedent të rrezikshëm në dhënien e lirisë elementëve kriminalë. Ministria prettoi reformë për rritjen e sigurisë në burgje si masa imediate kundër krimit të organi-



## SORECA

### AMBASADORI I BE

Ambasadori i Bashkimit Europoian, Luigi Soreca ka reaguar ashpër për vendimin e Gjykatës së Apelit, ku Dritan Dajti iu hoq burgjimi përjetë. "Vendimi i Gjykatës së Apelit për zvogëlimin e dënimit të të pandehurit të dënuar për vrasjen e 4 policëve bën thirrje për vlerësim urgjent nga KLGJ dhe prokurori i përgjithshëm. Reforma është e pakthyeshme dhe do të mbulojë të gjitha nivelet e juridiksionit", - thekson ambasadori i BE.

## ISH-KRYEMINISTRI BERISHA

"Miq, lidhjet e krimit të Edi Ramës me Dritan Dajtin, që datojnë në fillimet e viteve 2000 janë universalisht të njohura. Këto lidhje të ngushta dhe më pas edhe komunikimet e tij elektronike dhe të tjera me Dritan Dajtin në qeli. Manovrimet e Edvinit për ta liruar i kam denoncuar publikisht në parlament dhe media mbi 20 herë. Kështu që ekzekutimi për herë të dytë tri ditë më parë i katër martirëve të rendit dhe sigurisë është vetëm finalizimi i një veprimtarie kriminale të krye kreut Edvin Kristaq Krimi. Duke dënuar edhe një herë këtë akt, i paprecedent në historinë e këtij vendi, dhe autorin e tij Edvin Kristaq Krimi, ftoj shqiptarët t'i japin sa më parë kreut të meduzës së krimit të organizuar në Shqipëri përgjigjen e merituar!"

zuar. "Mbështes prokurorinë në ankimimin në Gjykatën e Lartë, me qëllim që parregullsitë e procesit në Apel të riven doshen në vend. Qytetarët shqiptarë meritojnë një sistem drejtësie ku gjyqtarët dhe prokurorët me kurajë, përgjegjshmëri dhe në zbatim të ligjit të marrin vendime të drejta, të pandikuara nga asnjë lloj rrethana tjetër dhe të japin drejtësi", përfundoi Gjonaj.

## "S'DO KETË PAQE"

Kështu ka deklaruar ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, për të folur për rastin "Dajti". Ai tha se nuk do ketë paqe derisa të zhbëhet vendimi për Dritan Dajtin, duke e cilësuar

një atentat ndaj drejtësisë. "48 orët e fundit kanë qenë orë të përjetimeve të rënda për familjarët e oficerëve të rënë në krye të detyrës më 7 gusht të vitit 2009, për Policinë e Shtetit dhe për gjithë qytetarët shqiptarë, si pasojë e një vendimi kriminal të disa gjyqtarëve që meritojnë plotësisht t'u bashkohen prapa hekurave klientëve të tyre. Kam pritur këto 48 orë sa të sigurohesha që ky krim i njerëzve me imunitet ligjor dhe kushtetues të mos kishte si përgjigje vetëm një deklaratë publike, por edhe një reagim të fortë e të vendosur si dhe një proces të qartë ligjor", tha ministri Lleshaj. Ministri kërcënoi



me burg gjyqtarët, duke u shprehur se ka nisur tashmë operacionin "Forca e Ligjit" për këtë rast. "Edhe pse nuk mund të jap detaje, deklaroj se operacioni 'Forca e Ligjit' është vënë në veprim të plotë për të adresuar me të gjithë forcën e së drejtës atentatin e qartë, brutal dhe skandaloz që i është bërë drejtësisë në vendin tonë, sakrificave të panumërta dhe gjakut të derdhur nga qindra punonjës të Policisë së Shtetit shqiptarë përgjatë tri dekadave të fundit". Lleshaj siguroi qytetarët se përgjigja e institucioneve do të jetë e fortë dhe ligjore. "Unë siguroj qytetarët shqiptarë dhe familjarët e dëshmorëve të atdheut nga radhët e Policisë së Shtetit se përgjigja e institucioneve do të jetë e fortë, ligjore, në përjesëtim të drejtë dhe në respekt të plotë me thirrjen që buron nga amaneti i atyre burrave të Policisë së Shtetit shqiptar, që dhanë jetën për një Shqipëri më të sigurt dhe më drejtë", deklaroi Lleshaj.

## MINISTRI I BRENDSHËM

"Nuk mund dhe nuk do të ketë paqe në shpirtin e Policisë së Shtetit, por as edhe tek unë si ministër i Brendshëm, derisa ky vendim jo vetëm të zhbëhet nga Gjykata e Lartë, por edhe derisa autorët e këtij akti të pashembullt dhe fyes për gjakun e të gjithë dëshmorëve të PSH të përballen me ligjin dhe drejtësinë e vërtetë. Ata që krijuan kushtet dhe lejuan rritjen kriminelëve me profil të rrezikshëm dhe që jo rrallë u bënë njësh me ta, sot lajnë duart, madje përpiqen të krijojnë dhe kapital politik".



## Ngjarja në 2009-ën, Dritan Dajti: U vetëmbrojtta, s'e dija që ishin policë

Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda rrezoi vendimin për burgim të përjetshëm për Dritan Dajtin dhe pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar, çka do të thotë se dënimi tashmë është 25 vite burg. Ai akuzohet për vrasjen e 4 policëve. Dritan Dajti u pranng në vitin 2009 dhe u vu nën akuzë për veprën "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", kryer ndaj punonjëseve të policisë Fatos Xhani, Sajmir Duçkollari, Altin Dizdari, Kastriot Peskaq, por këto akuzat ai i mohoi duke deklaruar se qëlloi me armë për t'u vetëmbrojtur pa e ditur se ata ishin policë. Në atë ngjarje u vra edhe shoku i Dajtit, Ledion Mara, si dhe u plagos një pushues. Në asnjë seancë gjyqësore Dritan Dajti nuk ka pranuar që t'i ketë vrarë katër punonjësit e policisë me një qëllim, por ai ka theksuar se në përleshjen e asaj dite është vetëmbrojtur për shkak se i ishte hapur një luftë dhe qëllonin në drejtim të tij. Ai u dënuar nga të gjitha shkallët me burg përjetë, por Gjykata e Lartë ktheu dosjen për rrygkim në Apel për shkelje procedurale.

# INTEGRIMI RAPORTI

Kryeministri inspektoi punimet në rrugën që lidh Maliqin me njësitë administrative

## Rama: E kanë kot, s'na ndal dot asgjë për të bërë dallimin me të shkuarën

*"Nuk jemi si ata që i bëjnë me daulle"*

Maliqi do të lidhet me njësitë e tij administrative, Libonikun dhe Drithasin, me një rrugë të re, të standardeve bashkëkohore. Në rrugën ekzistuese, pothuajse e pakalueshme, është hapur kantieri i punimeve që pritet të përfundojnë brenda 7 muajve. Rruga do të ketë trotuare nga të dy krahët, korsi për biçikletat, gjelbërim dhe sistem ndriçimi. Punimet janë inspektuar nga kryeministri, Edi Rama i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë Maliq, Gëzim Topçiu. Kreu i qeverisë theksoi se ky investim shumë i kërkuar nga banorët e zonës do të sjellë edhe një zhvillim në aspektin zhvillimit ekonomik, pasi do mundësojë lëvizjen më të lehtë të produkteve bujqësore drejt tregut. "Në Maliq ka disa potenciale që mund të zhvillohen edhe për turizmin edhe për agroturizmin. Këtu njerëzit janë shumë punëtorë, janë shumë të dedikuar, mirëpo rruga ishte një tmerr i madh që e priste hovin e njerëzve për të ardhur, ose për t'u rikthyer. Tani besoj, nga pikëpamja e projektit është goxha e bukur, goxha turistike si rrugë", - u shpreh kryeministri Rama. Janë rreth 17 mijë banorë në Libonik dhe 8 mijë banorë në Maliq që e



Kryeministri Rama gjatë inspektimit të rrugës në Maliq

### RRUGA

"Këtu njerëzit janë shumë punëtorë, janë shumë të dedikuar, mirëpo rruga ishte një tmerr i madh, që e priste hovin e njerëzve për të ardhur, ose për t'u rikthyer. Tani besoj, nga pikëpamja e projektit është goxha e bukur, goxha turistike si rrugë"

shkelin këtë rrugë, në total 25 mijë banorë. Por, ky është segmenti në hyrje të qytetit, të cilin e lëvizin të gjithë banorët e Bashkisë Maliq që janë rreth 68 mijë banorë. Ky aks është jo vetëm një segment hyrës, por një aks i përbashkët që

lidh qytetin me fshatrat përreth dhe e bën një qytet të tërë. Kreu i qeverisë falënderoi banorët e Maliqit për besimin që i kanë dhënë me votë, ndërsa theksoi se jo gjithmonë qeveria ia ka dalë të bëjë atë që ka premtuar. "Mos më falëndero-

ni mua, por faleminderit juve që na keni dhënë besimin dhe ne do të mundohemi ta kthejmë besim në punë. Jo gjithnjë ia kemi dalë t'i bëjmë punët sipas do të donim, por hap pas hapi do ti bëjmë gjërat", tha Rama. Kryeministri Rama përgëzoi angazhimin e teknikëve dhe inxhinierëve, ndërsa theksoi se e rëndësishme është që investimi të bëhet mirë dhe me standarde. "Se u bë në qershor, se u bë në gusht, nuk ka ndonjë ndryshim të madh, rëndësi të bëhet mirë. Ne nuk jemi si ata që i bëjnë me daulle dhe pastaj të linte shkopin t'i bije vetë", - tha Rama. Rruga ka një gjatësi të përgjithshme prej 2,5 km. 1.1 km prej të cilave është rrugë e re që do të ndërtohet për këmbësorët, 8 metër gjerësi për qarkullimin e automjeteve, trotuare, rrugë për biçikleta, pjesë të gjelbëruar dhe 2200 ndriçues. Punimet parashikojnë prishjen e të gjitha ndërtimeve të paligjshme dhe do të ketë mure dekorativ guri dhe kangjella, duke sjellë në realitet infrastrukturën hyrëse më të bukur në qytetin e Maliqit. Ndërkohë që ditën e djeshme ai e nisi me publikimin e një projekti ku prezantoheshin ambientet e reja të Bashkisë së Korçës të rinovuara tërësisht, që e shoqëronte edhe me një mesazh të qartë për kundërshtarët politikë. "E kanë kot, s'na ndal asgjë dot për të bërë dallimin e madh mes të ardhmes e të shkuarës", - shkroi kryeministri Rama.



### SHKURT

## Balla në Përrenjas, inspekton punimet për shkollën e re

Drejtesi politik i qarkut të Elbasanit, Taulant Balla, i shoqëruar nga deputeti socialist Nuri Belba, inspekton dje nga afër punimet për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare "Dilaver Nezha" në Qukës Shkumbin, Prrenjas. Investimi po realizohet falë një fondi prej 289 milionë lekë të akorduara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Shkolla e re që do t'u shërbejë së shpejti 290 nxënësve të kësaj zone, do të ketë ambiente krejtësisht të transformuara dhe një sistem ngrohjeje qendrore plotësisht bashkëkohor. "Ky projekt në fakt u nis si projekt rikonstruksioni, por për shkak të problematikave që ndodhën gjatë implementimit të projektit u desh të ndryshohet projekti për të vazhduar me një ndërtim tërësor të shkollës. I kemi kërkuar kompanisë të planifikojë edhe sistemin e ngrohjes. Do të na duhet që të ndërhyjmë për të garantuar edhe funksionimin dhe furnizimin e kaldajes, me qëllim që në një zonë të ftohtë sikurse është Qukës-Shkumbini, ne të garantojmë që edhe kjo shkollë të ruajë të njëjtin standard që jemi munduar të implementojmë në tri vitet e fundit, pothuajse në të gjitha shkollat e qarkut të Elbasanit, i cili garanton ruajtjen e temperaturave, po ashtu edhe sistemin e ngrohjes me kaldajë. Duhet të kemi parasysh që gjithmonë në gjithë këto shkolla sistemi i ngrohjes ka qenë jo vetëm joeficient, por edhe në dëm të mjedisit dhe nuk garantonte një arsimim funksional në klasa", u shpreh Balla.



### SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G. Ballit Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoja, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 06.03.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lirisë për shlyerjen e pasurisë së paligjshme. Apartament me sipërfaqe totale 45.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1-26, Vol.13, Fq.41, Zk.3976 në pronësi të Hipotekësistit shoq. Sina Konstruktion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 10.147.2 (Dijetë miqje e njëjtd e gjyzei e shtatë pikë dy) EUR dhe Apartament me sipërfaqe totale 63.3 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk.3976 në pronësi të Hipotekësistit shoq. Sina Konstruktion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 14.179.2 (Kasëmbëlljetë miqje e njëjtd e shtatë pikë dy) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

United Nations Development Programme

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

**Post Title:** Technical Specialist - Maritime

**Type of Contract:** Service Contract (SC)

**Project:** Enhancing the Development of Albanian Maritime Sector through Technical Assistance and Increased Partnership

**Duty Station:** Tirana, Albania

**Duration of Assignment:** one year with possibility of extension

**Deadline for Application:** February 21, 2019

**Job Description:** <http://al.undp.org>  
Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>.

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

**LEGALIZIMET**

Në janar 2017 deri prill 2018 janë lëshuar lejet e legalizimit për 34,650 objekte të paligjshme. Për vitin 2017 janë lëshuar 26,451 leje dhe për periudhën janar-prill 2018 janë lëshuar 8,199 leje legalizimi.

**SHKURT**

## 200 "skiftere" shqiptarë në Europë, BE kërkon ndihmën e Shqipërisë

Krahas Task-Forceve të ndryshme që funksionojnë kundër krimit apo korrupsionit brenda vendit, Shqipëria dhe vendet e BE-së kanë ngritur edhe një Task Force "Anti-skifter", e cila fokusohet në shtetasit shqiptarë të përfshirë në veprat penale të vjedhjes në vendet e BE-së. Gjatë vitit 2018 qeveria raporton se kjo Task-Force përfundoi 3 operacione të përbashkëta me Belgjikën, Francën dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin. Sipas raportit të Këshillit të Ministrave, bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit është duke vazhduar me Danimarkën, Francën, Spanjën dhe vendet tjera të Bashkimit Evropian për 200 qytetarë shqiptarë që raportohet se merren me vjedhje nëpër vendet e BE.

## Vitin e shkuar u bllokuan 15 mln euro, vinin nga burime të dyshimta

Drejtorja e Parandalimit të Pastrimit të Parave të Pista ka mundur të bllokojë më shumë se 15 milionë euro përgjatë vitit që lamë pas. Këshilli i Ministrave raporton se gjatë 10 muajve të parë të vitit 2018, për veprat penale pastrimi i të ardhurave nga veprat penale ose veprimtari kriminale janë sekuestruar pasuri kriminale me vlerë mbi 15.3 milionë euro të 326 rasteve (4,046,615 euro në llogaritë bankare, 7,766,000 euro në asete, 3,497,150 në para/kartëmonedhë), nga të cilat 2,077,431 euro vetëm në muajin tetor 2018. Ndërkohë që për të njëjtën periudhë 10-mujore, në lidhje me Ligjin Nr. 10192 "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit" (Ligji Antimafia), pasuritë e sekuestruara ishin me një vlerë prej 16,530,000 euro (në pronë të luajtshme dhe llogari bankare), nga të cilat 600,000 euro vetëm në muajin tetor 2018.

Raporti, në 2018 u sekuestruan 2,300 kg droga të ndryshme me vlerë 18 mln euro

# Bilanci i Reformës në Drejtësi, 50 gjyqtarë dhe prokurorë të shkarkuar

## Krimet i janë konfiskuar 21 mln euro pasuri

Më shumë se 55 për qind e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk kanë arritur të kalojnë provimin e vetingut, mes të cilëve edhe persona të rëndësishëm të drejtësisë shqiptare, siç është rasti i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese apo edhe anëtarë të tjerë të Gjykatës së Lartë dhe prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme. Vetëm gjatë vitit 2018 nga 92 gjyqtarë, prokurorë dhe ndihmës ligjorë që kanë kaluar në sitën e vetingut, plot 50 prej tyre ose janë shkarkuar nga komisionet e vetingut ose janë tërhequr vetë më parë për të mos u diskredituar gjatë kontrollit. Këto janë të dhënat zyrtare që jep raporti vjetor i Këshillit të Ministrave për 2018-ën, me anë të të cilit ai informon Kuvendin e Shqipërisë mbi ecurinë e procesit të integritetit evropian, ku ndërmjet të tjerave flet edhe për rezultatet e deritanishme të Reformës në Drejtësi.

**VETINGU**

Sipas këtij dokumenti, deri në datën 24 dhjetor të 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë në total 92 vendime, ku 42 prej tyre për konfirmimin në detyrë të 20 gjyqtarëve, 18 prokurorëve dhe 4 ndihmësve ligjorë; 35 vendime për shkarkimin nga detyra ndërmjet të cilëve 22 gjyqtarë, 12 prokurorë dhe 1 ndihmësi ligjor; 7 vendime për ndërprerjen e procesit për 4 gjyqtarë, 2 prokurorë dhe 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe 8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë. Pra siç shihet, bëhet fjalë për më shumë se gjysmën e njerëzve të drejtësisë që kanë "ngelur në klasë" dhe për rrjedhojë janë larguar nga sistemi i drejtësisë. Po ashtu vlen të theksohet se nga 13 kandidatë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, 7 prej tyre janë shkarkuar, 4 janë konfirmuar në detyrë, për 1 është ndërprerë procesi i rivlerësimit dhe 1 tjetër është në proces rivlerësimi. Gjithashtu, raporti bën të ditur se nga 17 kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor, 6 prej tyre janë



shkarkuar nga detyra, për 1 është ndërprerë procesi i rivlerësimit dhe 10 prej tyre janë konfirmuar në detyrë. Po ashtu, nga 19 kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, 9 janë shkarkuar nga detyra, 10 janë konfirmuar në detyrë. **KORRUPSIONI** Qeveria raporton se gjatë vitit të shkuar janë ndërmarrë 445 veprime disiplinore për punonjës të administratës publike nga të cilët 102 rezultojnë të

jenë liruar nga shërbimi civil (33% prej të cilëve ishin nëpunës civilë të nivelit të mesëm ose të lartë), ndërsa 36 kallëzime penale janë dorëzuar në prokurori. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka pasur 1,099 raste të referuara në prokurori nga policia.

**KRIMI**

Sa i përket luftës kundër krimit të organizuar, raporti bën të ditur se vitin e sh-

kuar janë konfiskuar më shumë se 2,300 kg marijuanë, kokainë dhe heroinë, me një vlerë totale të vlerësuar prej 15 milionë eurosh. Sipas raportit, gjatë periudhës janar - nëntor 2018, Task Force Speciale përfundoi 22 operacione kundër 11 grupeve të strukturuar kriminale dhe arrestoi 175 nga drejtuesit dhe anëtarët e tyre si dhe sekuestrroi pasuritë e tyre kriminale, me vlerë rreth 20 milionë euro.

**VETINGU**

KPK ka dhënë në total 92 vendime, ku 42 prej tyre për konfirmimin në detyrë, 20 gjyqtarë, 18 prokurorë dhe 4 ndihmësve ligjorë; 35 vendime janë marrë për shkarkime nga detyra ndërmjet të cilëve 22 gjyqtarë, 12 prokurorë dhe 1 ndihmësi ligjor; 7 vendime për ndërprerjen e procesit dhe 8 vendime për pushimin e procesit.

### United Nations Development Programme

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

<b>Post Title:</b>	Project Assistant
<b>Type of Contract:</b>	Service Contract (SC)
<b>Project:</b>	Strengthening human resources, legal frameworks, and institutional capacities to implement the Nagoya Protocol (Global ABS Project)
<b>Duty Station:</b>	Tirana, Albania
<b>Duration of Assignment:</b>	one year with possibility of extension
<b>Deadline for Application:</b>	February 21, 2019
<b>Job Description:</b>	<a href="http://al.undp.org">http://al.undp.org</a> Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <a href="http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/">http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/</a> .

Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

## AKSIONI I OPOZITËS

### INTERVISTA

Nënkryetari i PD: Nuk i çojmë njerëzit mish për top për të marrë pushtetin

# Paloka: Kemi presion nga qytetarët, duan largimin me forcë të Ramës

"Mbështetësit ndjehen me turp krah Ramës"

Valentina Madani

Edi Paloka, nënkryetar i PD-së dhe Ku vendit, paralajmëron kryeministrin Edi Rama se më 16 shkurt shqiptarët do të derdhen në rrugë, ndaj ai ka në dorë që të zgjedhë formën e largimit nga qeveria. "Në të kundërt - thotë Paloka, - qytetarët do ta largojnë nga karrigia e kryeministrit". Z.Paloka përmes "Gazeta Shqiptare" tregon presionin që shqiptarët anëmbanë vendit po bëjnë për largimin me forcë të z.Rama. I bindur se më 16 shkurt Edi Rama nuk do të jetë më kryeministër, nënkryetari demokrat flet për atë çfarë do të ndodhë më pas, duke përmendur se nuk është e rëndësishme data, por vlefshmëria e zgjedhjeve. Edi Paloka shprehet se brenda vitit do të zhvillohen dy palë zgjedhje, ato lokale dhe parlamentare. "Në qershor apo jo, lokale, parlamentare, apo të dyja bashkë, zgjedhjet do të zhvillohen pasi ato janë e vetmja mënyrë demokratike që shqiptarët të zgjedhin drejtuesit e tyre lokalë dhe parlamentarë", deklaroi z.Edi Paloka.

**Z.Paloka, opozita ka paralajmëruar protesta kundër qeverisë, të cilat do të kulmojnë më 16 shkurt, por cili është konkretisht synimi i tyre?**

Protestat kanë mbetur përfundimisht e vetmja formë reagimi ndaj një kryeministri jo vetëm të shurdhër dhe indiferent ndaj problemeve të qytetarëve, por edhe arrogant ndaj kërkesave më minimale dhe jetësore të tyre. Kemi parë në gjithë këto vite një kryeministër që angazhon qeverinë dhe përdor të gjitha resurset dhe të gjithë pushtetin vetëm në shërbim të tij,



## LARGIMI

"Në këto kushte janë qytetarët, që me mijëra prej kohësh i kërkojnë opozitës të organizojë revoltën popullore, me një qëllim të vetëm, largimin me forcë të së keqes që quhet Edvin Rama. Largimi i kësaj qeverie është hapi i parë nga do të fillojë ndryshimi", deklaroi nënkryetari i PD.

familjes së tij dhe një grushti miqsh të lidhur po me interesa të tij. I pangopur për vete dhe mizor me ata që po i mbysin hallet e problemet. Kemi parë një kryeministër që përdor pushtetin dhe paratë e shqiptarëve për të realizuar edhe teka ekstravagante të tij; kryeministër që merr çarterin për të bërë një foto me Kristiano Ronaldo, apo që ia dedikon kohën hapjes së ekspozitave personale në galeritë më të njohura e më të shtrënjta në gjitha anët e botës. Është po ky kryeministër që tërbohët, bëhet arrogant, kërcënon e sulmon njerëz që ngrënë zërin se nuk kanë bukë për fëmijët e tyre. Është ky që burgos njerëz që protestojnë, sepse për shkak të planeve korruptive të qeverisë mbeten pa shtëpi e hidhen në rrugë të madhe. Është

ky që tërbohët kur studentet reagojnë se nuk përballojnë dot shkollimin e u dërgon policinë e Lleshit t'i dhunojë. Sot ka marrë në dorë kontrollin e gjithçkaje; ka një qeveri me kukulla, një parlament privat, drejtësi të kapur, media nën urdhër dhe një të ashtuquajtur shoqëri civile, që jo vetëm nuk reagon, por shpesh është vënë në shërbim të Ramës, duke u kthyer në zjarfikëse të reagimit qytetar. Kjo e ka bërë që Rama të nxjerrë gjithnjë e më shumë fytyrën e tij të vërtetë, atë të një genieje diz humane dhe brutale, të cilës arroganca dhe cmenduria i janë bërë bashkë. Tanimë është e qartë se me një kryeministër i cili fut në listën e armiqtve dhe quan "kazan" këdo që guxon qoftë edhe t'i verë në dukje gabimet, rrugët poli-

## ZGJEDHJET

"Data e zgjedhjeve për mua, por besoj për këdo, është e parëndësishme krahasuar me vlefshmërinë e zgjedhjeve. Sidoqoftë, ne duhet të përgatitemi dhe po përgatitemi sepse në qershor apo jo, lokale, parlamentare apo të dyja bashkë, zgjedhjet do të zhvillohen pasi ato janë e vetmja mënyrë demokratike që shqiptarët të zgjedhin drejtuesit e tyre lokalë dhe parlamentarë", tha z.Edi Paloka.



## AKUZA

"Sot ka marrë në dorë kontrollin e gjithçkaje. Ka një qeveri me kukulla, një parlament privat, drejtësi të kapur, media nën urdhër dhe një të ashtuquajtur shoqëri civile, që jo vetëm nuk reagon, por shpesh është vënë në shërbim të Ramës, duke u kthyer në zjarfikëse të reagimit qytetar", akuzoi z.Paloka.

## trit Edi Rama?

Ju thashë, vendimi nuk është i PD-së, por i qytetarëve dhe jo vetëm PD-ja, por e gjithë opozita është angazhuar në organizimin e protestës më të madhe që ka ndodhur ndonjëherë në këtë vend.

## Atëherë do i çoni njerëzit si "mish për top"...

Ne e kemi shprehur më se një herë se nuk i çojmë njerëzit mish për top për të marrë pushtetin si Edvin Rama, prandaj po e përsëris se vendimi për largimin e kësaj qeverie është i qytetarëve e në këto kushte, ata vendosin edhe se si e realizojnë vendimin e tyre. Ne jemi bashkë me ta. Kam bindjen se kur i gjithë ai popull të dalë në rrugë, do i duhet Ramës të marrë vendime të shpejta, sepse në një mënyrë apo një tjetër, do të jetë ai që do të përcaktojë mënyrën se si preferon ta zbatojë

vendimin që kanë marrë qytetarët për fatin e tij.

**Cilat janë motivet e protestave që do të organizohen në rrethe? Cili është konkretisht kalendari i protestave? Për çfarë tematikash, apo problematikash do të protestohet?**

Motivi i protestave janë problemet e qytetarëve, që rëndohen gjithnjë e më shumë e jo vetëm nuk gjejnë zgjidhje, por hasen edhe me arrogancën gjithnjë e më absurde të Ramës. Motivi është jeta e gjithsecilit e vështirësuar dhe përkeqësuar si kurrë më parë; varfëria, papunësia, mungesa e ndihmës sociale, pensionet mizerabel, pamundësia për t'u arsimuar siç duhet, shëndetësia që është bërë më e shtrënjtë e njëkohësisht e rënë në mënyrë drastike në cilësi e shërbim, pasiguria totale, korrupsioni dhe krimi, të gjitha këto të

tike kanë mbaruar. Në këto kushte janë qytetarët, që me mijëra, prej kohësh i kërkojnë opozitës të organizojë revoltën popullore, me një qëllim të vetëm, largimin me forcë të së keqes që quhet Edvin Rama. Largimi i kësaj qeverie është hapi i parë nga do të fillojë ndryshimi.

**Vendimi politik i PD-së për të nisur një sezon protestash, a do të çojë drejt një aksion radikal për largimin e kryeminis-**



### PROTESTA

"Ne e kemi shprehur mëse një herë se nuk i çojmë njerëzit mish për top për të marrë pushtetin si Edvin Rama, prandaj po përsëris se vendimi për largimin e kësaj qeverie është i qytetarëve e në këto kushte, ata vendosin edhe se si e realizojnë vendimin e tyre", u shpreh z.Paloka.

lidhura direkt me kryeministrin dhe qeveritarët.

### Si do i bindni qytetarët që të vijnë në protestë për të rrëzuar Edi Ramën?

Ju thashë, nuk jemi ne që duhet të bindim qytetarët, janë ata që na kanë kërkuar të vihemi në krye e të organizojmë protestat dhe revoltën kundër Ramës. Ju e shihni që sot në krah të Ramës kanë mbetur vetëm ata që janë të zhytur si ai në llum. Nuk ka mbetur asnjë njeri me pak dinjitet që nuk është distancuar prej tij. Edhe mbështetës të njohur të tij dikur janë detyruar të deklarojnë publikisht se ka ardhur koha që Rama të largohet. Të tjerë ish-mbështetës të tij që nuk iu bënë goja të shpallin domosdoshmërinë e largimit të Ramës janë tërhequr në heshtje, sepse e kanë kuptuar se të jesh sot në krah të tij është mëse e turpshme. Për këto arsye, Rama

po tenton në mënyrë të dëshpëruar të luajë një gur të fundit, duke shfrytëzuar zhgënjimin jo pa arsye të shqiptarëve nga politika. Duke u përpjekur të tregojë se e gjithë politika është njësoj e qelbur, dëshpërimisht iu kërkon të lënë atë në karrige e të mos tentojnë të ndryshojnë gjërat. Thashë që kjo është tentativë e dëshpëruar se tanimë shumica absolute e shqiptarëve janë të bindur që Edi Rama duhet larguar, sepse largimi i tij është kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të ndaluar të keqen e për të filluar ndryshimin. Pas kësaj, shqiptarët vetë do të vendosin se çfarë alternative do të zgjedhin, por unë mendoj që tanimë PD-ja po e konsolidon besimin për të ardhmen e afërt, jo vetëm të shqiptarët, por edhe të ndërkombëtarët. Sidoqoftë, kjo do të shihet në hapin tjetër, pasi të jetë

po tenton në mënyrë të dëshpëruar të luajë një gur të fundit, duke shfrytëzuar zhgënjimin jo pa arsye të shqiptarëve nga politika. Duke u përpjekur të tregojë se e gjithë politika është njësoj e qelbur, dëshpërimisht iu kërkon të lënë atë në karrige e të mos tentojnë të ndryshojnë gjërat. Thashë që kjo është tentativë e dëshpëruar se tanimë shumica absolute e shqiptarëve janë të bindur që Edi Rama duhet larguar, sepse largimi i tij është kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të ndaluar të keqen e për të filluar ndryshimin. Pas kësaj, shqiptarët vetë do të vendosin se çfarë alternative do të zgjedhin, por unë mendoj që tanimë PD-ja po e konsolidon besimin për të ardhmen e afërt, jo vetëm të shqiptarët, por edhe të ndërkombëtarët. Sidoqoftë, kjo do të shihet në hapin tjetër, pasi të jetë

po tenton në mënyrë të dëshpëruar të luajë një gur të fundit, duke shfrytëzuar zhgënjimin jo pa arsye të shqiptarëve nga politika. Duke u përpjekur të tregojë se e gjithë politika është njësoj e qelbur, dëshpërimisht iu kërkon të lënë atë në karrige e të mos tentojnë të ndryshojnë gjërat. Thashë që kjo është tentativë e dëshpëruar se tanimë shumica absolute e shqiptarëve janë të bindur që Edi Rama duhet larguar, sepse largimi i tij është kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të ndaluar të keqen e për të filluar ndryshimin. Pas kësaj, shqiptarët vetë do të vendosin se çfarë alternative do të zgjedhin, por unë mendoj që tanimë PD-ja po e konsolidon besimin për të ardhmen e afërt, jo vetëm të shqiptarët, por edhe të ndërkombëtarët. Sidoqoftë, kjo do të shihet në hapin tjetër, pasi të jetë

"Shqiptarët do derdhen në rrugë, largimi i qeverisë, hapi i parë i ndryshimit"

# Paloka: E rëndësishme jo data, por vlefshmëria e zgjedhjeve

"Rama po tenton të luajë gurin e fundit"

larguar Rama dhe një qeveri tranzitore t'u krijojë kushtet njerëzve për të zgjedhur lirisht.

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PD-së, Basha kërkoi mobilizimin e të gjithë demokratëve për të nisur një sezon protestash, të cilat do të kulmojnë me largimin e Edi Ramës. Sa të mundur e shikoni ju këtë?

Unë mendoj që jo vetëm demokratët, jo vetëm opozita, jo vetëm qytetarët që po ndeshen çdo ditë me vështirësitë e krijuara nga qeveria më e keqe që ka njohur ky vend në pluralizëm, por edhe çdo qytetar tjetër i përgjegjshëm për fatin e vendit të tij, brenda apo jashtë Shqipërisë sot duhet të reagojë. Dhe unë mendoj që po reagojnë. Nuk ka intelektual të mirënjohur të botës mbarëshqiptare që nuk ka kërkuar sot publikisht largimin e Ramës. E thashë edhe më lart, të konformohesh sot me Ramën është turp, por edhe përgjegjësi e madhe qytetare dhe patriotike, nëse doni. Unë e kam shprehur edhe herë tjetër, për mua largimi i Ramës sot është akt patriotik.

### Cili është plani i PD-së më tej, çfarë ndodh nëse Edi Rama nuk dorëhiqet?

Sigurisht që Rama nuk ka dëshirë të largohet, edhe pse e sheh shumë mirë që këtë sot e kërkojnë shumica absolute e shqiptarëve, por edhe ndërkombëtarët. Në këto kushte, siç thashë edhe më lart, me reagimin e tij, ai ka në dorë të vendosë vetëm mënyrën se si do të largohet. Zgjedhjet, Rama ua ka hequr shqiptarëve si opsion për largimin e tij, por pas largimit të Ramës, zgjedhjet do të jenë i vetmi opsion për përcaktimin se kush do të qeverisë më tej.

A do hyjë PD në zgjedhjet lokale të 30 qershorit? A ka nisur bisedimet PD-ja me aleatët për zgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet lokale?

Paralelisht me përgatitjen e protestave, strukturat e PD-së kanë



### ARSYET

"Rama po tenton në mënyrë të dëshpëruar të luajë një gur të fundit, duke shfrytëzuar zhgënjimin jo pa arsye të shqiptarëve nga politika. Duke u përpjekur të tregojë se e gjithë politika është njësoj e qelbur, dëshpërimisht u kërkon të lënë atë në karrige e të mos tentojnë të ndryshojnë gjërat", tha z.Paloka.

marrë udhëzimet që të vazhdojnë edhe me përgatitjen për zgjedhje. Ky është një proces që sigurisht përfshin përzgjedhjen e kandidatëve si një element mjaft i rëndësishëm, përfshi kandidatë për pushtetin lokal, por edhe për parlamentin. Data e zgjedhjeve për mua, por besoj për këdo, është e parëndësishme krahasuar me vlefshmërinë e zgjedhjeve. Sidoqoftë, ne duhet të përgatitemi dhe po përgatitemi sepse në qershor apo jo; lokale, parlamentare apo të dyja bashkë zgjedhjet do të zhvillohen, pasi ato janë e vetmja mënyrë demokratike që shqiptarët të zgjedhin drejtuesit e tyre lokalë dhe parlamentarë.

Si e shikoni ekipin e ri të z. Basha të dalë nga zgjedhjet e brendshme në PD, pjesë e të cilit jeni edhe ju vetë? Pjesa më e madhe e sekretariateve

përbëhet nga njerëz teknikë. A frymëzoni ekipin e ri, sipas jush? Nisur nga lista e propozuar nga z.Basha për anëtarë në Këshillin Kombëtar të PD-së, por edhe në kryesi, duket se ka një tentativë për të afruar sa më shumë kontribuues të PD-së në struktura të larta të partisë. Kush tjetër duhet t'i bashkohet PD-së?

Ai që ju e quani "ekipi i ri" përfshin nga themelues të PD-së, njerëz dhe personalitete që kanë mbi 20 vite në politikë, deri te figura të reja në drejtim, por jo në politikë. Me këtë dua të them se nuk jam dakord me atë që shprehet ju se sekretariatit përbëhet nga "teknikë". Është e vërtetë që sekretariatit përbëhet nga individë me cilësi dhe performancë të lartë në profesionet e tyre, por kjo nuk i bën apolitike apo "teknike", përkundrazi. Pothuajse të gjithë ata

### LARGIMI

"Në këto kushte, siç thashë dhe më lart, me reagimin e tij, ai ka në dorë të vendosë vetëm mënyrën se si do të largohet. Zgjedhjet Rama ua ka hequr shqiptarëve si opsion për largimin e tij, por pas largimit të Ramës, zgjedhjet do të jenë i vetmi opsion për përcaktimin si do të qeverisë më tej", deklaroi nënkryetari i Kuvendit.

kanë një jetë jo të shkurtër politike dhe do të thosha kontribute domethënëse në politikën e opozitës, parësish se jo të gjithë, për arsye objektive kanë bërë atë që quhet "jetë partie". Ato që unë do evidentoja te ky "ekip", përveç të tjerave, janë përkushtimi ndershmëria, që duket se sot janë veti të rralla në politikë. Siç kam thënë edhe një herë tjetër, as gojë e qelbura të "rilindjes" nuk arrijnë t'i bëjnë dot pis dhe dua të rikujtoj që te ky ekip nuk ka vetëm të rinj, por edhe politikane që profesionalizmin dhe ndershmërinë e tyre e kanë treguar edhe në poste ministrash.

# PENSIONET E PLEQËRISË NDRYSHIMET

Kushtet e përfitimit/ ISSH: Bazohet në vitet e punës me kontribute dhe pagën

## Ndryshon moshën e daljes në pension, sa do të jetë për 2019

Tabelat e plota të viteve për burrat e gratë

Voltiza Duro

Përfundimtarisht në këtë vit, ashtu siç parashikohet në legjislacionin shqiptar, ka pasur ndryshime përsa i përket moshës së daljes në pension për të gjithë individët që kanë minimumi 15 vite pune me kontribute. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot moshën e daljes në pension për 2019-ën si dhe 2020-ën. Aktualisht për vitin 2018-të, moshën e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e 8 muaj (rritjet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrijnë në 67 vjeç). Ndërkohë sipas kësaj llogaritjeje, moshën e daljes në pension për gratë në 2019-ën do të jetë 60 vjeç e 10 muaj, ndërsa në 2020 do të jetë 61 vjeç. Ndërkohë, burrat duhet të kenë mbushur moshën 65 vjeç, në mënyrë që të përfitojnë pagesën e pensionit të pleqërisë (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Në bazë të reformës së vitit 2014-të, masa e përllogaritjes së pensionit varet nga vitet e punës dhe paga, pra pensioni është produkt i viteve të sigurimit dhe pagës mbi të cilin janë paguar kontributet. Sa më shumë vite të ketë aplikanti dhe sa më e lartë të ketë qenë paga e tij, aq më e lartë do të jetë masa e përfitimit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se vjetërsia e plotë kontributeve për të dyja gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029. "Personat e siguruar që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji", theksohet në ligjin "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket pensionit të pleqërisë në vendin tonë. Ndërkohë, personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar deri tri vite para mbushjes së moshës së

daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 kur kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92; apo nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Ndërkaq, nënat që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë të rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim. "Për të lindur e drejta për pension pleqërie, kërkohen dy kushte, që janë vjetërsia

kontributive jo më pak se 15 vite kontributive dhe moshën, që përcaktohet sipas tabelës së paraqitur në nenin 43 të ligjit (që ndryshon nenin 92).

### KUSHTET E PËRFITIMIT

Për të përfituar pension pleqërie individit duhet të bazohet në kriteret, moshën dhe vitet e punës me kontribute. Domsdosmërisht individit duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 10 muaj për gratë e

mbi 65 vjeç për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit dhe në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individit mendon se ka 40



### DOKUMENTACION I PASAKTË

Librezat e punës mund të vlerësohen si e pasaktë në ato raste kur ka ndërrhyrje, falsifikim datash, korrigjime vulash apo dublikatë librezash. Punonjësit e ISSH-së duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individit ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

Për burrat	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v

Për gratë	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v 4m	60v 2m	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v 4m	35v 8m	60v 4m	35v 8m
01.01.2017 - 30.06.2017	57v	35	60v 6m	36v	60v 6m	36v
01.01.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v 8m	36v 4m	60v 8m	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v 10m	36v 8m	60v 10m	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v 2m	37v 4m	61v 2m	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v 4m	37v 8m	61v 4m	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v 6m	38v	61v 6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v 4m	35v 6m	61v 8m	38v 4m	61v 8m	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v 8m	36v	61v 10m	38v 8m	61v 10m	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v 6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v 4m	37v	62v 2m	39v 4m	62v 2m	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v 8m	37v 6m	62v 4m	39v 8m	62v 4m	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v 6m	40v	62v 6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v 4m	38v 6m	62v 8m	40v	62v 8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v 8m	39v	62v 10m	40v	62v 10m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033 - 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034 - 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v





Voltiza Duro

**F**ormula e përlogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti '75, kur individi ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientet e veta të indeksimit. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientet e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.

vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot. Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listëpagesat janë grumbulluar në arkivën e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individi ka punuar para vitit 1994, shërbën librezat e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page. Kur individi humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepen të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individi ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi. Dokumenti, pra librezat e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vulash apo dublikatë librezat. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me siguri ka një "ngërc" e menjëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, bordet, apo listëpagesat që të vërtetojnë faktin që individi ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

Shembujt konkretë, bazuar në vitet e punës me kontribute dhe pagat referuese

# Formula e re, si do të përlogaritet masa e pensionit për 2019-ën

Cilat janë ndryshimet te koeficientet e indeksimit



**FORMULA**  
PP (Pensioni i Pleqërisë) = PS (Pension Social)\* (shumëzuar) me vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) me vite sigurimi\* (shumëzuar) me BV (baza e vlerësuar). Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

## SHUMA E PAGAVE

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i pleqërisë) = PS (Pension Social) \*(shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100\* (shumëzuar) vite sigurimi\* (shumëzuar)BV (baza e vlerësuar).

### BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pa-

gat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit për-

para datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientet e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.

### SHEMBUJ KONKRETË

Për ta konkretizuar këtë problem po të marrim një pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratuar në masën 4.192 lekë, duke e shumëzuar me koeficientin 8.59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36.009 lekë. Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke u shumëzuar me koeficientin përkatës japin pagën për efekt të llogaritjes së pensionit. Po të marrim një rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14 830 lekë, duke u shumëzuar me koeficientin e indeksimit, që është 1,48 jep pagën minimale prej 22.000 lekë. Po kështu dhe paga maksimale e cila ka qenë 74.150, kur shumëzohet me po këtë koeficient indeksimi jep pagën maksimale aktuale 97.030.

### Koeficientet e indeksimit

Koeficientet e indeksimit janë ata koeficiente që kërkohen që pagën mbi të cilën janë paguar kontrib-

utet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indekset e ndryshimet që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koeficient 8.59. Pra, ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks sot është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientet respektive. Ndërkohë, pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individi edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individi i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni.

Televizioni italian interviston gazetaren Klodiana Lala: S'u trembem kërcënimeve

# Investigimi i "Rai 3": Mafia, pjesë e parlamentit shqiptar

Mafia shqiptare dhe mënyra e gjenerimit të të ardhurave të saj ka tërhequr vëmendjen e medias italiane. Televizioni "Rai 3", që ka zbarkuar në Tiranë, duke investiguar se ku po investohen paratë e pista. Pjesë e kronikës është edhe gazetaria Klodiana Lala, që shprehet se Shqipëria sot ndodhet në kushtet kur nuk flitet më vetëm për bashkëpunim të politikanëve me segmente të kimit, por sot, sipas saj, mafia ka hyrë edhe në parlament. Sektori i ndërtimit vijon të mbetet fusha e preferuar për pastrimin e parave të kimit-shton ajo. "Rai 3" thekson edhe kërcënimet që ka marrë gazetaria shqiptare nga grupet kriminale, por ajo shprehet se nuk trembet kur thotë të vërtetën. "Në Shqipëri kanë hyrë shumë para nga trafikimi i jashtëligjshëm, si droga dhe prostitucioni. Një pjesë e mirë e ndërtimeve të bëra në vend kanë ardhur si rezultat i këtyre të ardhurave". Ky është citimi i gazetares së kronikës, Klodiana Lala, gjatë një in-



### TV "RAI3"

"Rai 3" thekson edhe kërcënimet që ka marrë gazetaria shqiptare nga grupet kriminale, por ajo shprehet se nuk trembet kur thotë të vërtetën. "Në Shqipëri kanë hyrë shumë para nga trafikimi i jashtëligjshëm, si droga dhe prostitucioni. Një pjesë e mirë e ndërtimeve të bëra në vend kanë ardhur si rezultat i këtyre të ardhurave".

terviste për televizionin italian "Tg3". Pier Damiani D'Agata dhe Claudio Rubino kanë udhëtuar nga Roma për të intervistuar Klodiana Lalën. "Klodiana Lala është gazetaria shqiptare që jetën dhe karrierën e saj ia ka dedikuar dëshmisë së historive dhe bëmave të grupeve kriminale". "Nuk është lajm i ri bashkëpunimi i politikës me grupet kriminale. Por tashmë kemi vajtur në atë pikë, ku mafia ka hyrë në parlament", thotë Klodiana Lala. Ish-ministri i Brendshëm i qeverisë aktuale të Edi Ramës akuzohet për trafik ndërkombëtar droge dhe favorizim të klanëve të këtij spektri, sidomos kushëririn e

tij Moisi Habilaj, sot i dënuar nga Gjykata e Katantias. Pak ditë më parë, prokurori i Antimafies Italiane mbërriti në Tiranë dhe zbuloi se mafia është investitori më i madh në ekonominë shqiptare. "Risku është i madh, drejtësia është shumë e dobët, edhe pas hartimit të reformës në drejtësi në 2016-ën", thotë Klodiana Lala. Në gusht, shtëpia e prindërve të Klodiana Lalës u qëllua me breshëri automatik, tip kallashnikov. Ky ishte një sulm i qartë mafioz. "Nuk kam frikë. Nëse një gazetar thotë të vërtetën, nuk ka pse të ketë frikë nga asgjë", tha Klodiana Lala. (BalkanWeb)



## Zhduken 2 veta prej 5 ditësh, dyshimet

Dy persona janë deklaruar të zhdukur në Tepelenë dhe Përmet. Sokol Rama nga fshati Mamaj i Tepelenës është denoncuar i zhdukur nga familja, me të cilën ka humbur kontaktet prej 5 ditësh. Rama është një emër i njohur për policinë lokale. Ai është person me precedentë penalë, i akuzuar për vjedhje, ndërkaq dyshimet janë se zhdukja e tij dhe shokut të tij nga Përmeti me iniciale G.H. kanë lidhje me transportin e lëndëve narkotike, pasi Rama është identifikuar nga policia lokale si transportues i lëndëve narkotike. Telefonat në përdorim të tij janë vënë nën gjurmimin policor. Një prej numrave të telefonit del i figur, ndërkaq numri tjetër është identifikuar në Frashër të Përmetit. Dyshohet se personat janë fshehur në këtë zonë të thellë malore.

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER NOTIFICATION**

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING**  
**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentially Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING"  
The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**.  
Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 0355 4 2361 600 Fax: 0355 4 2361 545  
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

## Lihet në arrest shtëpie ish-sekretarja e përgjithshme e MD

Gjykata Penale e Tiranës ka lënë në arrest shtëpie ish-sekretaren e përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë, Juliana Hoxha. Ajo është pjesë e grupit të ish-zyrtarëve të kësaj ministrie, të arrestuar në lidhje me abuzimet me tenderat në këtë dikaster. Hoxha u arrestua së bashku me 10 zyrtarë të tjerë, me dyshimin se kanë abuzuar me 5 tendera në periudhën 2016-2017, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm disa milionë euro. Gjykata ka lënë në fuqi masën arrest me burg vetëm për specialistin e IT-së Lusien Ali, i shpallur në kërkim. Vetëm Ali do të hetohet nën masën e arrestit me burg, 8 ish-zyrtarë do të hetohen në gjendje të lirë dhe 3 të tjerë në arrest shtëpie. Pas gjetjes së shkeljeve, prokuroria ngriti dyshime për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" dhe "shkeljes së barazisë në tendera" për zyrtarë e ish-zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë. Përveç 12 zyrtarëve, ka nisur verifikimi edhe për urdhrat e 3 ish-ministrave të Drejtësisë për të parë se cili ka qenë roli i tyre në këto 5 tendera. Për këtë, ata do të merren në pyetje në prokurori. Abuzimet fillimisht u zbuluan pas auditit të Ministrisë së Financave, ku rezultoi se tenderat ishin me probleme financiare. Sipas hetimeve të prokurorisë, janë gjetur shkelje të rënda në tenderin e mbikëqyrjes elektronike për të burgosurit, mirëmbajtjen e regjistrimit noterial dhe atë për mbimarim; tenderit të pajisjes me kamera të burgut të Fushë-Krujës dhe Lezhës, si dhe ai i regjistrimit 'online' të 7 Gjykatave Administrative.

## Protesta e kavajasve në Tiranë: "Nuk luhet përdhunimesh"

Shoqëria civile ka dalë sot në protestë rreth një javë pas publikimit të skandalit për përdhunimin e një të miture në shkollën "Rilindja" të Kavajës. Protestuesit nisën marshimin drejt Drejtorisë së Policisë dhe më pas u vendosën para Ministrisë së Arsimit. Ata përcollën disa mesazhe përmes pankartave, ndërkaq deklaruan se nuk do të ketë fjalime, por vetëm marshim. Fillimisht ishte ish-kryeministri Sali Berisha që denoncoi skandalin e ndodhur në shkollën 9-veçare dhe akuzoi policinë për fshehjen e ngjarjes. Policia deklaroi se kishte referuar ngjarjen në prokurori që me denoncimin e nënës, por se nuk kishte publikuar të dhëna për rastin për të mbrojtur 13-veçarën e abuzuar. Ndërkaq, mazhoranca akuzoi opozitën se po përdorte ngjarjen dhe u shpreh kundër mediatizimit të rastit, megjithatë të premtën ministrja Elisa Spiropali nxori me zë e figurë prindërit e minorenes dhe videoja u publikua nga kryeministri Edi Rama..

## PËRVJETORI

"Si u zgjodh Tirana sepse nuk ishte nën kontrollin e asnjë pushtuesi"

# Nga Tirana orientale, në Tiranën evropiane

Nga Andriola Kambo

Sot Tirana kryeqytet feston 99-vjetorin e ditëlindjes së saj. Rrugëtimi ndër vite e përmes ngjarjeve të pafund e të natyrave nga më të ndryshmet, të ngjarjeve të mëdha e kthesave historike e ka sjellë Tiranën në pamjen e statusin që ka sot. Historia e këtyre gati 100 viteve ka vendosur vulën e saj kudo nëpër Tiranë.

Për ta njohur këtë histori të kryeqytetit të shënuar e të dokumentuar nga historianë e intelektualë si dhe nga qytetarë autoktonë tiranas mjafton që të ravigjëzohen disa nga momentet kryesore të saj.

Tirana që në agimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar u ndodh në pararojen e qyteteve e të forcave atdhetare që ngritën flamurin kombëtar e që dërgoi përfaqësuesit e saj në Kuvendin Kombëtar të Vlorës për t'i dhënë jetë në 28 nëntor 1912 ëndrrës së brezave për një Shqipëri të lirë e të mosvarme. Tirana përjetoi kalvarin e pushtimeve të huaja gjatë Luftës së Parë Botërore, por qytetarët më të përkushtuar e më të ndërgjegjshëm të saj nuk e humbën shpresën dhe as nuk shquan pas pinjollëve të degraduar të ndonjë familje të madhe të saj, që nga etja e pafund për pushtet ishte gati të shiste të gjithë Shqipërinë. Ata në përfundim të luftës u bashkuan me atdhetarët e vërtetë të mbarë Shqipërisë për të rivendosur lirinë e pavarësinë e nëpërkëmbur të atdheut e për të ndaluar njëherë e mirë një copëtim tjetër të trojeve shqiptare në pazaret e diplomacisë evropiane.

Pikërisht atëherë kur një grup atdhetarësh krijuan Komisionin për organizimin e një kongresi kombëtar për shpëtimin e Shqipërisë. Kryetari i Katundarisë së Tiranës (1918 - 1922) Ismail Ndroqi kërkoi që ky kongres të mbahej në Tiranë. E nëse kongresi për arsye të ndryshme nuk u arrit të mbledhej në Tiranë dy përfaqësues të shquar të saj, Abdi Toptani e Mytesim Këlliçi shkuan në Lushnjë e morën pjesë në kongresin historik që u zhvillua atje në dhjetëditëshin e fundit të muajit janar 1920. "Populli i Tiranës, i madh e i vogël e priti me një gëzim të madh" organizimin e Kuvendit Kombëtar të Lushnjës, thuhet në një dokument të kohës. Për merita të tyre, por edhe si përfaqësues të Tiranës, Abdi Toptani, firmëtar i aktit të pavarësisë kombëtare u zgjodh nga Kongresi një prej katër anëtarëve të Këshillit të Lartë, ndërkohë që Mytesim Këlliçi u zgjodh senator në Këshillin Kombëtar.

Delegatët e Kuvendit të Lushnjës në përfundim të tij në rrethanat e krijuara, në 9 shkurt morën



vendimin që Tirana të shpallej kryeqytet i përkohshëm i Shqipërisë. Në 11 shkurt anëtarët e Këshillit të Lartë, Aqif Pashë Elbasani, Abdi Toptani, Mihal Turullu e Imzot Luigj Bumçi u zgjodhën të shkonin në Tiranë së bashku me qeverinë e re me në krye Sulejman Delvinën dhe delegatët e tjerë të Kuvendit. Atë ditë ata u pritën me solemnitet nga kryetari i Katundarisë së Tiranës, Ismail Ndroqi dhe nga shumë qytetarë të kryeqytetit të ri. Forcat italiane të pushtimit ashtu siç u përpoqën të pengonin organizimin e Kongresit të Lushnjës, po ashtu edhe tentuan të mos lejonin delegatët, qeverinë e Këshillin e Lartë të hyjnë në Tiranë por dështuan.

Zgjedhja e Tiranës si kryeqytet i përkohshëm i Shqipërisë nuk ishte thjesht një rastësi e diktuar nga rrethanat e krijuara në Shqipërinë që ende kishte trupa pushtimi të huaja në territorin e saj. Është e vërtetë që kur u shpall pavarësia e Shqipërisë ka pasur diskutime se cili do të ishte kryeqyteti i shtetit të ri shqiptar. Madje në këto diskutime kanë marrë pjesë jo vetëm faktorët e brendshëm politikë e social shqiptarë por edhe qeveri e përfaqësues të fuqive të mëdha evropiane të kohës. Përveç Vlorës në të cilën u shpall pavarësia dhe veprimi qeveria e parë kombëtare e Ismail Qemalit, pretendime serioze ka pasur edhe Durrësi si kryeqytet i Principatës së Vidit, por edhe Shkodra, Elbasani, madje edhe Kruja. Gjith-

## Diskutimet e 99 viteve më parë se cili do të ishte kryeqyteti i shtetit të ri shqiptar

secila nga këto kandidatūra ka pasur favorë e saj, argumente politike, ekonomike, sociale, gjeografike, ashtu siç kanë pasur edhe minuset e tyre.

Tirana u përzgjedh si kryeqytet me argumentin e fortë se ajo ishte jashtë zonës së kontrollit ushtarak italian, siç ishte Vlora e Durrësi e jashtë kërcënimeve të forcave jugosllave siç ishte Shkodra, afër të cilës ishin dislokuar trupat ushtarake të Beogradit. Elbasani gjithashtu nuk mund të ishte për shkak të influencës negative të Shefqet Verlacit, i cili ishte një kundërshtar i rreptë i Kongresit të Lushnjës. Tirana kishte edhe një argument të favorshëm gjeografik: ajo ndodhë në qendër të vendit, me një shtrirje hapësinore të gjerë për modelimin e një qyteti të ri, me një distancë të shkurtër nga Deti Adriatik e me një mburojë mbrojtje si mali i Dajtit. Ishte ashtu siç ëndërronte ideologu i Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri: "Mezi i Shqipërisë, domethënë kryeqytet i përgjithshëm, do të jetë një nga qytetet, që ndodhet në mes të Shqipërisë, e në të cilët flitet gjitha shqip... në një vend të shëndetshëm e të bukur, me udhë të gjera e të drejta me shtëpi të mira, me sheshe e me gjithë ç'duhet".

Krijimi i institucioneve të reja të shtetit shqiptar nuk ishte i lehtë. Mungonin godinat, zyrat dhe

ranës përmes zgjedhjeve në vitin 1922 ka qenë Ali Bega, ndërsa pasi Tirana u bë përfundimisht kryeqytet, në janar 1925, kryetar u zgjodh Fuat Toptani, në dhjetor të atij viti.

Tirana si kryeqendra politike e Shqipërisë përcolli të gjitha ngjarjet më të mëdha e më të rëndësishme të vendit. Ajo njohu përplasjet dhe kthesat e mëdha politike, përjetoi qeveri e qeverisje autoritariste e diktatoriale, pushtimin fashist e çlirimin e saj prej tij. Tirana ka reflektuar e ka fiksuar në truallin e në memorien e saj natyrën e regjimeve që kanë kaluar, konceptet e shijet e tyre të qeverisjes. Të gjithë deri në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX-të kanë dhënë kontributet e tyre për të mirë e për të keq për të pasur atë Tiranë që kemi sot me disa përjashtime.

Tirana e pasviteve '90 të shekullit të kaluar ka pësuar ndryshime në disa drejtime. Ajo tashmë është bërë metropoli i botës shqiptare me rreth një milionë banorë, me një jetë intensive politike, ekonomike, kulturore, arsimore e shkencore. Por duke humbur monotoninë e një qetësie të imponuar nga regjimi monist, Tirana fitoi një dinamikë që solli ndryshime thelbësore në mënyrën e jetesës, në shtresëzimin social, në intensitetin e vetë jetës qytetare. Por solli edhe fenomene negative politike, ekonomike e sociale, kriminalitet të organizuar e ordiner, informalitet e ndotje ambienti, e shumë e shumë gjëra të tjera shqetësuese.

Qeverisja e Tiranës është një sfidë e madhe, sepse në kryeqytet jeton e punon rreth një e treta e popullsisë së vendit. Qytetarët e Tiranës kanë qenë e mbeten gjykatësit më të mirë të cilësisë së qeverisjes në vite të kryeqytetit, të investimeve që janë bërë e të përkushtimit që ka karakterizuar ekipet drejtuese bashkiake të tij. Do të ishte e pëlqyeshme që në këtë rast të ketë adresime falënderuese për të gjithë ata që kanë kontribuar për zhvillimin e Tiranës. Tirana po transformohet në stil e në përmbajtje në një qytet të admirueshëm evropian ku ka kuptim e shpresë për të jetuar e punuar e me sytë nga e ardhmja evropiane. Kjo është edhe një arsye që duke hedhur vështrimin prapa në ditën e themelimit të Tiranës si kryeqytet e duke e përkujuar atë me të gjitha ndërmert që meriton t'i japim atij (asaj) edhe një garanci tjetër për vazhdimësinë e qeverisjes e të drejtimit nga ata që e kanë treguar me punë e me vpra që e duan Tiranën, që i janë përkushtuar asaj dhe mirëqenies së qytetarëve të saj.

Administrimi dhe qeverisja e Tiranës si kryeqytet u vendos mbi baza ligjore që nga viti 1922. Në janar të këtij viti Këshilli Kombëtar aprovoi ligjin mbi zgjedhjet e këshillave të bashkive, i cili pasi u miratua edhe nga Këshilli i Lartë hyri në zbatim. Mbi këtë bazë në Tiranë u zhvilluan zgjedhjet e para bashkiake për kryetar e këshillin bashkiak. Kryetar i parë i Bashkisë së Ti-

**Mahmood fiton "Sanremon": "Jam 100% italian". Salvini reagon keq**

**Egjiptiani rrëmben kupën, reagon vendi i dytë: Populli është fitorja ime, kishim katërfishin e vlerësimit**



grupit "Il Volo". Fituesi ka thënë: "Faleminderit të gjithëve, nuk po arrij ta besoj!". E shpërbleu televotimi pas klasifikimi të përkohshëm, që e kishte vendosur në vendet e para së bashku me tre djemtë "Il Volo" dhe super të favorizuarit Ultimo. Në fund kënga e tij "Soldi" mori çmimin e madh. Pas fi-

tores, Mahmud u shpreh: "Unë jam 100% italian, nëna ime është nga Sardenja dhe babai im është egjiptian, por unë kam lindur dhe jam rritur në Itali". Ndërkohë, Matteo Salvini u shpreh kundër fitores së 27-vjeçarit. "Mahmood... mah... Kënga italiane më e bukur! Unë do kisha zgjedhur Ultimion, si

mendoni?", ka pyetur zëvendës kryeministri italian në "Twitter". Ndërkaq ka reaguar edhe vendi i dytë me anën e një postimi në "Twitter". Por, pas polemikave u pendua dhe e fshiu. "Populli është fitorja ime. Nga shpëtimia votat ishin katërfish në krahasim me të tjerë. Këngët që unë shkruaj, s'janë të mijat. Nëse i pëlqejnë Salviniut apo një muratori, apo dikujt tjetër, mua s'më ndryshon asgjë!", ka thënë Ultimo në deklaratën e tij.

Protestuesit tentojnë të hyjnë në Asamblenë Kombëtare, përlëshen me policët

**"Jelekët e verdhë" tentojnë të pushtojnë Parlamentin**

*Mbi 30 persona arrestohen, një 21-vjeçar humbet dorën*

Ditën e djeshme vijuan protestat e "jelekëve të verdhë" në Francë, të cilët kanë hyrë tashmë në javën e 13, por që vihet re se janë po aq të dhunshme sa në ditën e parë. Dhuna këtë fundjavë u zhvendos përpara Parlamentit. Qindra protestues u përlëshën ashpër me policinë gjatë tentativave për të pushtuar Asamblenë Kombëtare. Policia përdori granatat shokuese për të larguar protestuesit. Një protestues 21-vjeçar humbi njërin dorë, pasi granata i shpërtheu në dorë. Mbi 30 protestues u arrestuan. Dhunës dhe shkatërrimit nuk i shpëtuan automjetet luksoze të parkuara pranë Parlamentit. Ndërsa në Lion "jelekëverdhit" u përplasën me një grup radikalësh të djathtë. Përplasja u përshkrua nga dëshmitarët që xhiruan pamjet si luftë civile. Dhunën këtë javë e shkaktoi një ligj i miratuar në parlament kundër hulumtimit gjatë protestave, që ndalon manifestuesit të mbulojnë fytyrat, çka prek drejtëpërdrejtë "jelekëverdhit". Protesta e tyre ka shkakuar tensione diplomatike mes Francës dhe Italisë. Zv.kryeministri italian, Di Maio ka lidhur aleancë me "jelekëverdhit" francezë, me të cilët synon krijimin e një koalicioni në Parlamentin Europian, pas zgjedhjeve të majit. Ndërkaq, mbështetja e qeverisë italiane për "jelekëverdhit" në Francë i ka tensionuar marrëdhëniet mes dy vendeve fqinjë. Qeveria në Paris është e indinjuar dhe bën fjalë për një provokim të papranueshëm. Pas grindjeve prej disa javësh mes qeverisë së Francës nën presidentin Emmanuel Macron dhe qeverisë populiste të djathtë në Romë, Parisi e ka tërhequr për konsultime ambasadorin e vet nga Roma. Ndërhyrjet e fundit të Italisë në politikën e brendshme franceze janë një "provokim i papranueshëm", komunikoi Ministria e Jashtme franceze. Mbështetja e lëvizjes së "jelekëve të verdhë" nga politika e Romës "cenon respektin për të cilin janë të detyruara ndaj njëra-tjetrës qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të lirë".



Në fokus, zgjedhjet për Parlamentin Europian Përfaqësuesi i qeverisë franceze u shpreh i indinjuar edhe ndaj takimit të fshehtë të zëvendëskryeministrit italian, Luigi Di Maio, me përfaqësues të "jelekëve të verdhë" të martën (06.02) në Paris. Vetëm katër muaj para zgjedhjeve për Parlamentin Europian, qeveria në Romë është angazhuar fare hapur për lëvizjen protestës, që kërkon tërheqjen e presidentit Macron. Kalkulimi që me sa duket bëjnë populistët është të fitojnë pikë në elektorat për zgjedhjet europiane. Di Maio nga lëvizja populiste "Pesë yjet" është takuar me disa kandidatë të "jelekëve të verdhë" për zgjedhjet europiane në fund të majit, ndër ta edhe me zëdhënësin e lëvizjes së protestës, Christophe Chalenc-

con. Ky është si figurë e diskutueshme për shkak të deklaratimeve të tij ksenofobe dhe kundër islamizimit. Mes "jelekëve të verdhë" dhe lëvizjes "Pesë yjet" ka shumë "pikëtakime", deklaroi zyra e Di Maios. Kjo ka të bëjë me temat për drejtësinë sociale, demokracinë direkt dhe mjedisin. "Era e ndryshimeve i ka kaluar alpet", pati komunikuar Di Maio pas takimit me "jelekëverdhit". Front kundër Macron

Qeveria e Italisë, e përbërë nga lëvizja "Pesë Yjet" dhe partia radikale e djathtë "Lega" qysh muajin e kaluar i mbështeti "jelekëverdhit". "Jelekëverdhit" jini të qëndrueshëm", pati deklaruar Di Maio gjatë protestave. Zëvendëskryeministri italian dhe ministri i Brendshëm Matteo Salvini pati deklaruar se ai mbësht-

**Trazira në Torino, 4 të plagosur, në pranga 11 protestues**

Skena guerrilase urbane në Torino, ku marshimi i protestës së anarkistëve, i organizuar pas dëbimit të një azilanti të punësuar prej vitesh ka rezultuar me dhunë, hedhje gurësh, zjarrvënje nëpër koshë dhe përplasje me policinë. Në fund të ditës, policia ndaloi 11 vetë. Ata janë akuzuar për shkatërrime, posedim dhe hedhje të objekteve shpërthyes, rezistencë të rënduar, bllokim rrugës. Katër persona kanë mbetur të plagosur, një prej të cilëve është rëndë. Njëmbëdhjetë protestuesit u arrestuan për përlëshjet e ndodhura dhe vënie zjarri në një zonë afër qendrës historike të Torinos. Situata është normalizuar pas pothuajse dy orëve përlëshjes. Me koshat e përmbysur, anarkistët krijuan barriera në rrugë, duke përhapur panik midis kalimtarëve dhe banorëve. Një grup anarkistësh sulmuan një autobus të linjës në qytet, duke terrorizuar shoferin dhe udhëtarët. Pasi hipën në bord, demonstruesit shkatërruan autobusin dhe hodhën gaz lotsjellës. "Nuk kam parë kurrë diçka të tillë - tha shoferi - ata u ngjiten me kapuç, duke shkatërruar gjithçka, unë ende po dridhem". Hedhjes së objekteve në rrugë, policia iu përgjigj me gaz lotsjellës, ndërsa turma ka thyer shenja dhe barriera rrugore dhe ka përmbysur shumë kazanë plehrash në mes të rrugës.

**SALVINI: NË VEPRIM KRIMINELËT**  
"Torino dhe qytetarët e saj - tha Matteo Salvini - janë peng i disa qindra kriminelëve të qendrave sociale. E gjithë mbështetja ime shkon tek torinezët dhe policia, për këtë kriminelë udhëtimi falas ka mbaruar". Zëvendëskryeministri italian shtoi: "Burg për këta të poshtër. Kemi çuar gati në zero zbarkimet e emigrantëve, tani do të mbyllem qendrat sociale të frekuentuara nga kriminelët".

tet "qytetarët seriozë" në protestën e tyre kundër presidentit Macron, i cili qeveris "kundër popullit të tij". "Jelekëverdhit" në manifestimet e tyre të përjavshme kërkojnë dorëheqjen e Macronit dhe distancimin nga politika e tij sociale.

**MOLLË SHERRI, POLITIKA E MIGRACIONIT**  
Qeveria italiane prej kohësh është në konflikt me Macronin, ndër të tjera për shkak

të politikës së saj restriktive ndaj emigracionit. Macron e akuzoi Rimën për "cinizëm" dhe "mungesë përgjegjësie", pasi Italia refuzoi të pranonte ankimin në portet e saj të anijeve me refugjatë. Di Maio u kundërvu duke deklaruar se emigrimi masiv nga Afrika është pasojë, që "vende të caktuara europiane, në radhë të parë Franca, asnjëherë nuk janë ndalur së kolonizuar vendet afrikane".

**SHKURT**  
**Katalonja, protesta masive në Spanjë kundër bisedimeve**  
Mijëra protestues janë mbledhur në Madrid të dielën në shenjë qëndresë kundër planit të qeverisë spanjolle të uljes së tensioneve në rajonin e Katalonjës. Partia Qendrore Djathtë dhe Partia Qytetare kanë thirrur protestën pasi kryeministri Pedro Sanchez u ofroi separatistëve një raportues për bisedime. Partia Djathtë e ka konsideruar këtë ofertë si tradhti dhe dorëzim. Separatistët kanë refuzuar ofertën. Edhe socialistët e kundërshtojnë pavarësinë e Katalonjës. Grupet ekstreme djathtë janë po ashtu pjesë e protestës nën moton "Për Spanjën e bashkuar. Zgjedhje menjëherë". Autoritetet raportuan se numri total i demonstruesve arriti në 45 mijë.

**Elizabeth Warren zyrtarizon kandidaturën për presidente të SHBA**  
Senatorja demokratike, Elizabeth Warren e bëri zyrtare sot kandidaturën e saj për presidente të Shteteve të Bashkuara në qytetin Lawrence, të shtetit Masaçusets, të njohur për popullsinë e tij të klasës punëtore. Tematika e fushatës së saj duket tashmë se bazohet në thirrjen populiste për të luftuar pabarazinë ekonomike dhe për të ndërtuar "një Amerikë që funksionon për të gjithë". Senatorja Warren bëri një thirrje të fortë për ndryshim, duke denoncuar "tkurrjen e klasës së mesme" që ka lënë amerikanët të shtypur me "shumë pak logaridhënie për të pasurit dhe shumë pak mundësi për të gjithë të tjerët". Ajo dhe mbështetësit e saj shpresojnë se ky mesazh do ta spikase në një kamp të mbingarkuar kandidatësh demokratë, si dhe do ta ndihmojë të lërë pas debatin rreth pretendimeve që pati bërë për origjinin e saj nga indianët e Amerikës. Senatorja Warren shmangu sulmet direkte ndaj Presidentit Donald Trump, ndërsa ndërthuri në fjalën e saj përjasje ndaj çështjeve politike, si një sistem kujdesi shëndetësor për të gjithë, apo eliminimin e "lobizmit të Uashingtonit në formën që ekziston tani". Masaçusets është shteti i saj dhe senatorja Warren e shpalli kandidaturën në një zonë industriale, ku 100 vjet më parë punëtorët e fabrikave filluan grevën e tyre.



## YLLI MERJA:



Si të kuroni  
spondiloartrozën  
cervikale me vajra  
esencialë

## GJINEKOLOGU



Elton Peçi:  
Testet që duhet të  
kryeni gjatë  
shtatzënisë

## LORELA GARULI:



Psikologia:  
Problemet mund të  
përmirësohen, por  
nuk zhduken  
përfundimisht

## Si të kuptoni që fëmija vuan nga çrregullimet e të nxënit

"Duhet të ketë bashkëpunim mes  
prindërve dhe mësuesve"

## 9 gabimet që shpejtojnë procesin e plakjes

Psikologia: Problemet mund të përmirësohen, por nuk zhduken përfundimisht

# LORELA GARULI: Si të kuptoni që fëmija vuan nga çrregullimet e të nxënimit

*"Duhet të ketë bashkëpunim mes prindërve dhe mësuesve"*

Voltiza Duro

Shpeshherë ndodh që fëmijët etiketohen nga mësuesit apo prindërit si nxënës dembelë apo që nuk duan të mësojnë. Por e vërteta mund të jetë shumë ndryshe. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", psikologja Lorela Garuli tregon se këta fëmijë mund të vuanin nga çrregullimet e të nxënimit, që i bën të mos kenë performancë të kënaqshme në orën e mësimit. Fëmijët e prekur nga çrregullime të tilla shfaqin probleme dhe lexojnë në mënyrë të pasaktë, shkruajnë në mënyrë të paqartë, nuk arrijnë të kuptojnë përmbajtjen e teksteve, kanë shumë gabime në përdorimin e numrave dhe logaritjen e tyre, mbajtjen mend të shifrave dhe të procedurave të matematikës. Psikologja thekson se duhet të evidentohen qartë rastet dhe të krijohet një urë bashkëpunimi mes prindërve dhe mësuesve për gjetjen e zgjidhjeve alternative për këta fëmijë.

**Mund të na tregoni se çfarë janë çrregullimet e të**

**fëmijët e prekur nga këto çrregullime?**

Fëmijët shfaqin vështirësi apo dëmtime të ashpra në të gjitha këto aftësi, që lidhen me këto lëndë shkollore: matematikë, lexim dhe drejtshkrim. Konkretisht, fëmijët që vuajnë një çrregullim lexojnë në mënyrë të pasaktë, shkruajnë në mënyrë të paqartë, nuk arrijnë të kuptojnë përmbajtjen e teksteve, kanë shumë gabime në përdorimin e numrave dhe logaritjen e tyre, mbajtjen mend të shifrave dhe të procedurave të matematikës. Duhet



**nxënit dhe cilat mekanizma prekin?**

Çrregullimet e të nxënimit kanë në thelb të gjitha proceset, mekanizmat që janë në themel të të studiuarit dhe të të nxënimit, që janë tre: të lexuarit, shkrimi dhe vështirësi në matematikë. Të gjitha këto rezultojnë të jenë detyra komplekse për fëmijët, për shumicën dërrmuese të tyre, por edhe për ata që i mësojnë këto procese pa shumë vështirësi. Megjithatë, kur bëhet fjalë për çrregullimet e të nxënimit, ajo që duhet të dimë është që për këta fëmijë e nxënës, shkronjat, numrat, rrokjet, fjalët, fjalitë, veprimet e thjeshta matematikore, të numëruarit etj., mund të kthehen labirinte të vërteta, pra klasifikohen si çrregullime të të nxënimit. **Cilat janë disa prej problematikave që shfaqin**

specifikuar, se çrregullimet e të nxënimit janë të lindura, mund të prekin çdo fëmijë, pavarësisht statusit social-ekonomik, kërkojnë kohë dhe angazhim për t'u trajtuar dhe diagnoza për çrregullimin e disleksisë bëhet në përfundim të klasës së parë, ndërsa për diskalkulinë, fëmijës i jepet më shumë kohë dhe diagnoza, nëse do të kemi një të tillë, do të vendoset në fund të klasës së tretë.

**Mund të na përshkruani disa prej simptomave që shfaqin vogëlushët, të cilat prindërit nuk duhet t'i neglizhojnë?**

Çrregullimet e të nxënimit kuptohen dhe përkufizohen sipas manualeve psikologjike dhe në thelb të tyre qëndron vështirësia në të nxënën dhe në përdorimin e shprehive akdemike, sikurse e përmendëm më lart. Përtej shprehive shkollore, këta fëmijë ndeshin edhe shumë vështirësi psikologjike, si vetëbesim të ulët, vetëkoncept jo pozitiv, u duket vetja të paaftë, jo të zgjuar, sepse shohin që nuk po ndjekin dot ritmin e bashkëmoshatarëve të



Psikologja Lorela Garuli

klasës, ndihen të brishtë emocionalisht, lodhen shumë shpejt, nuk kanë përqendrim, nuk e duan shkollën, sepse nuk është një mjedis që i "mirëpret".

**Sa është numri i fëmijëve të prekur nga çrregullimet e të nxënimit në vendin tonë?**

Sa u përket shifrave të fëmijëve të prekur nga këto çrregullime në Shqipëri, nuk ka. Ne mund t'u referohemi statistikave që vinë nga vendet e tjera, për shembull në Itali, në një studim të vitit 2012, rezultatet kanë treguar se shpërndarja e çrregullimeve të të nxënimit është rreth 3.2%, që do të thotë përafërsisht 3 ose më shumë në 100 nxënës mund të vuajnë nga këto çrregullime. Duhet specifikuar që janë tri lloje çrregullimesh të të nxënimit. Është disleksia, që është grupi më i madh, që ka të bëjë më leximin, është çrregullimi që lidhet më të shkruarin; disortografia dhe disgrafia, si dhe grupi i tretë, i matematikës që është diskalkulla.

A ka raste kur fëmijët vuajnë nga më shumë se një lloj çrregullimi?

Shpeshherë fëmijët nuk vuajnë vetëm nga një lloj çrregullimi. Disleksia, grupi i parë, më i përhapuri që mbizotëron, por ndodh që një fëmijë mund të vuajë nga të tria llojet e çrregullimeve ose prej dy prej tyre.

**Vetë fëmijët e kuptojnë kur janë të prekur nga çrregullimet e të nxënimit? A ka një mënyrë trajtimi përfundimtare të problemit?**

Janë të vetëdijshëm që diçka nuk shkon mirë me ta, që etiketohen shumë. Duhet shpjeguar paralelisht me punën didaktike, arsimore dhe edukative, duhet bërë një punë shumë e madhe edhe në planin emocional, afektiv dhe psikologjik, duke i sqaruar që "ti do t'i mësosh të gjitha, do kapësh ritmin e shokëve të klasës", sepse ky është problem që fëmijët kanë. Gjithmonë duhet punuar me motivimin e këtyre fëmijëve. Për sa kohë që një çrregullim i lindur, neurologjik për shembull nuk zhduket. Patjetër që kalon në një farë mase, zbehet, përmirësohet, rregullohet, evoluon, sepse çrregullimi ndryshon.

Mund të jetë më i rëndë në vitet e para të shkollimit, kur fëmija përballë në mënyrë direkte me të gjitha aftësitë dhe shprehitë që kanë të bëjnë me të nxënimit.

**Cilat janë masat që duhet të marrin mësuesit për trajtimin e këtyre fëmijëve?**

Këtyre fëmijëve duhet t'u vijë në ndihmë edhe sistemi arsimor, struktura, sepse të paktën në vendet fqinje, ku këto çrregullime janë të njohura me legjislacion, këta fëmijë kanë mënyra të ndryshme se si mësojnë. Sa i përket vazhdimësisë gjatë jetës, pas përfundimit të shkollës, këto vështirësi mund të flenë, mund të jenë më të fshehura, por patjetër që shfaqen, në momente të caktuara të përditshëm, në varësi të situatave.

**A janë të aftë mjaftueshëm mësuesit dhe prindërit për të evidentuar rastet e prekura?**

E vërteta është se lidhur me këto çrregullime mungon shumë informacioni dhe ndërjegjësimi. Shumë herë janë mësuesit, ata që nuk i kuptojnë dhe nuk dinë t'i evidentojnë dhe kjo sepse tek ne mungon informacioni, mjetet, teknikat, instrumentet e nevojshme për të identifikuar këta fëmijë dhe për të kuptuar realisht problematikën që kanë. E njëjta situatë është edhe në familje. I gjithë ky presion psikologjik dhe i gjithë ky mospikim për situatën e tyre rëndon sigurisht mbi supet e fëmijës, i cili ndihet i demotivuar, nuk ndihet inteligjent e shumë elemente të tjera. Shumë herë e identifikojnë si indiferent, si një fëmijë që nuk do të mësojë, si një fëmijë që neglizhon mësimet, si një fëmijë dembel. Këto janë etiketimet, por në fakt e vërteta nuk është kjo.

**Cilat janë këshillat tuaja për prindërit e fëmijëve me çrregullime të të nxënimit?**

Ka raste kur prindi arrin të identifikojë vështirësitë dhe ua raporton mësuesve, ose anasjelltas. E rëndësishme është që mësuesi të tregojë profesionalizmin e duhur dhe prindit bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e duhur. Nëse një fëmijë identifikohet dhe ndjek terapinë e duhur, disa herë në javë, patjetër që ka përmirësime. Me këta fëmijë nuk është e vështirë që të punosh. E rëndësishme është që puna të jetë sistematike dhe e vazhdueshme.



Voltiza Duro

Mjeku popullor: Kryeni aktivitet fizik dhe mos qëndroni gjatë në kompjuter

**S**pondilozatoza është një sëmundje që prek qafën, veçanërisht në periudhën e dimrit, për shkak të të ftohtit dhe temperaturave të ulëta. Ndërkohë, spondilozatoza cervikale është një dëmtim i vertebrave cervikale në vertebrat nga C1-C7. Kjo sëmundje mund të shkaktohet nga dëmtime të vertebrave të qafës për shkak të qëndrimit të keq, leximit me orare të zgjatura, trauma në qafë, apo dëmtime për shkak të aktivitetit fizik etj.. Qafa nuk duhet përkulur përpara më shumë sesa 30 gradë gjatë leximit, punës në kompjuter apo çdo aktiviteti tjetër.

**KATEGORITË E RISKUARA**  
Grupi më i rrezikuar për t'u prekur nga sëmundja e cervikales është grupmosha mbi 50 vjeç, por vihet re një përhapje gjithnjë e më e madhe tek individët 20-30 vjeç. Këto grupmosha janë duke u ekspozuar ndaj kësaj sëmundjeje për shkak të faktorëve si studimi apo puna në kompjuter. Studentët në universitet që kalojnë shumë kohë duke studiuar kanë shumë shpesh dhimbje koke e marrje mendsh dhe vuajnë pa e kuptuar nga cervikalja. Gjithashtu, preken edhe individët që qëndrojnë për një kohë të gjatë në kompjuter apo nuk kryejnë aktivitet fizik dhe bëjnë një jetë sedentare. Ka shumë raste të individëve që kanë pasur mpirje të dorës dhe gishtave dhe kanë menduar se kanë probleme me nervat e dorës, apo probleme në tru dhe kanë marrë ilaçe për të qetësuar nervat e dorës. Por kjo është shpeshherë një shenjë e spondilozatozës, pasi nervat e qafës fillojnë të mos furnizohen mjaftueshëm me gjak dhe oksigjen dhe shkaktojnë mpirje të dorës, shkaktojnë mungesë të përqendrimit dhe të sëmurët nuk ndihen të kthjellët nga ana mendore.

**SIMPTOMAT**

Spondilozatoza ka disa simptoma si: dhimbje koke të shpeshhta që mund të kalojë nga pjesa e pasme e kokës anash saj, dobësim të shikimit, marrje mendsh nëse lëvizet koka majtas - djathtas. Gjithashtu nëse personi vëren te zona e qafës, një pjesë të dalë është më i rrezikuar për të vuajtur nga spondilozatoza.

Parandalimi  
Këshillohet që të kryhen shpesh ushtrime fizike dhe individit mos të

# YLLI MERJA: Si të kuroni spondilozatozën cervikale me vajra esenciale

*"Kujdes, përhapja e sëmundjes edhe te moshat e reja"*



Ylli Merja

rrijë pasiv gjatë gjithë kohës. Nëse puna lidhet me kompjuterin, duhet të bëhen pushime 10 minuta çdo ore, të qetësohen sytë dhe qafa. Nuk duhet të bëhen lëvizje të shpejta të menjëhershme të qafës dhe koka nuk duhet përkulur më shumë se 30 gradë.

**TRAJTIMI ME BIMË MEDICINALE**

Përdorimi i vajit të sinapit dhe ekstraktit të variceve ka dhënë shumë rezultat në shërimin e spondilozatozës dhe ka ndihmuar në ndalimin e dhimbjeve të kokës vetëm pas ditës së parë të trajtimit. Këto përzije kanë dhënë shumë rezultate deri në largimin e mpirjes së dorës

që shkaktohet nga spondilozatoza. Dy ekstraktet përdoren për rreth një muaj për të përfunduar kurën e plotë. Në rastet më të avancuara të sëmundjes përdoret edhe një çaj miks, që ndihmon në rigjenerimin e kockave dhe përmban minerale të shumta ushqyese për të ndihmuar në brendësi të organizmit, ashtu si edhe jashtë. Kur jeni duke përdorur vajin dhe ekstraktin këshillohet të vendosni një shall gjatë ditës, për ta mbajtur qafën gjatë gjithë kohës të lyster me vajin dhe në temperaturë të ngrohtë, që të mos preket nga era apo ajri i ftohtë.

Kjo kurë bimore ndihmon në hol-

limin e gjakut dhe lejon rrjedhshmëri të tij në kyçe dhe inde; si dhe ka efekt qetësues në qelizat nervore. Për të përgatitur çajin veproni kështu: zieni 2.5 litra ujë në një tenxhere e kur të jetë uji në valim shtohet 1 paketë me çajin, 1 lugë gjellë rozmarinë, 1 lugë gjelle lëvore shelgu dhe 1 lugë gjelle dëllinjë. Lihen të ziejnë vetëm 2-3 minuta. Mbulohet me kapak derisa të ftohet çaji. Pastaj konsumohet 3 gota në ditë, para ushqimit. Por mbi të gjitha përdoren ekstrakti i variceve dhe vaji i sinapit për cervikalen. Ek-

strakti i variceve nxit qarkullimin e gjakut. Ai përmban substanca të ndryshme (kapsaicinë, timol, cineol, acid triterpenoik) që luftojnë inflamacionin dhe ënjtjen, forcojnë enët e qarkullimit e gjakut. Vaji i sinapit nxit qarkullimin e gjakut në kyçe, shkrin kolesterolin dhe lubrifikon vertebrat. Ky vaj duke masazhuar qafën dy herë në ditë, zbut tendinat, lehtëson lëvizjen e vertebrave dhe qetëson dhimbjet.





## Gjinekologu Elton Peçi: Testet që duhet të kryeni gjatë shtatzënisë

**K**ujdesi shëndetësor prekonceptual është kujdesi që një grua në moshën e duhur për të lindur fëmijë merr përpara shtatzënisë. Ky lloj kujdesi mbikëqyr faktorët biomjekësorë, të sjelljes dhe riskut social që mund të prekin shëndetin e gruas dhe të fetusit. Synimi është të ofrohet informacion dhe trajtim përpara shtatzënisë, që të mund të përmirësojë shëndetin e gruas dhe të ndihmojë në uljen e rreziqeve për fetusin. Analizat e tremujorit TQ parë janë: urine komplete/urokulturë, hemoleukograma dhe grupi i gjakut, testi Coombs indirekt, elektroforeza e hemoglobinës, glicemia, analizat e tiroides, provat hepatike, provat renale, toksoplazmoza (IgG, IgM), rubeola (IgG, IgM), citomegalovirus (IgG, IGM), analizat për sëmundjet seksualisht të transmetueshme (sifilizi, HIV-AIDS), testet virale të hepatitit (HBsAg, HVC), Ultrascreening-u (Bitest + Translucenca nukale dhe Kocka nazale).

### EKOGRAFIA OBSTETRIKALE E TREMUJORIT I

Ekografia obstetrikale e tremujorit të parë ndër të tjera ekzaminon: pozicionin e shtatzënisë (pra brenda apo jashtë uterusit), numrin e embrioneve, praninë e rrahjeve të zembrës, moshën e shtatzënisë (nga dita e parë e ciklit menstrual) etj. **DEPSTIMI PRENATAL I ANOMALIVE FETALE** Çdo shtatzëni ka një probabilitet të jetë e prekur nga anomali të ndryshme të fetusit (kromozomiale, gjenetike etj.). Përmes programeve të depistimit synojmë të veçojmë nga popullata e grave shtatzëna grupin që mbart riskun më të lartë për të qenë e prekur nga një anomali e caktuar. Këtyre shtatzënavë screen pozitive u ofrohet informacioni i detajuar dhe mundësia e diagnozës me anë të procedurave invazive të diagnozës prenatale.

**DIAGNOZA E ANOMALIVE FETALE** Për diagnozën prenatale nevojitet ekzaminimi i indeve/ qelizave fetale. Kjo mund të arrihet përmes procedurave invazive nën drejtimin e ekografisë (am-



Mjeku gjinekolog Elton Peçi

niocenteza, biopsia e vileve koriale, kordocenteza) të cilat duhen kryer nga një personel i specializuar në këtë drejtim.

Ekografia morfologjike është një standard që ofrohet edhe në Shqipëri. Për fat të keq një pjesë e shtatzënavë janë më tepër kompliante ndaj përcaktimit të seksit përmes ekografisë se sa ndaj ekografisë morfologjike. Veç depistimit të sindromës Down (më e shpeshta kromozomopati), ajo mund të diagnostikojë edhe malformime të tjera fetale.

### ANALIZAT E TREMUJORIT II (JAVA 15 - 28)

Është mjeku obstetër që do të vendosë frekuencën dhe renditjen e analizave/ekzaminimeve të mëposhtme: Triple test (java 15-18). Triple testi është një alternativë e mirë për depistimin e anomalive fetale tek shtatzënat që nuk kanë përfitur nga depistimi biokimik (bitest) në tremujorin I. Femrat që rezultojnë pozitive pas triple-test u

ofrohet diagnoza invazive (amniocenteza). Nëse moshën e gruas është më e madhe se 36 vjeç këshillohet amniocenteza (java 16). Ekografitë 3-dimensionale (3D) dhe 4-dimensionale (4D) janë bërë gjithnjë e më shumë popullore dhe gjithnjë e më shumë në dispozicion të pacientëve. Me ekografinë 3D, një seri seksionesh 2D rindërtohen në mënyrë dixhitale për të dhënë një pamje sa më reale. Me ekon 4D, dimensionin i shtuar është koha, ndaj duket sikur pamjet 3D lëvizin në kohë reale. Pamjet 3D/4D shfaqen zakonisht në ngjyrë të artë në ekranin e ekografisë, duke qenë se kjo është një ngjyrë që shquhet lehtë nga pacientët dhe thekson tigrat e bebes. Në fund të ekzaminimit, çifti pajiset me një CD ku përmbahen fotot/videoet e bebit të tyre. Duhet pasur parasysh se ekografia 3D/4D nuk është një ekografi emergjence dhe si e tillë duhet të kryhet gjithnjë me programim.



### ANALIZAT E TREMUJORIT III (JAVA 28 - 41)

Është mjeku obstetër që do të vendosë frekuencën dhe renditjen e analizave/ekzaminimeve të mëposhtme: hemoleukograma, urine komplete/urokulturë, ekografi obstetrikale (biometri fetale, velocimetria doppler, likidi amniotik, placenta, paraqitja fetale), provat hepatike, provat renale, uricemia, Non-Stres Testi, koagulograma, tampon vaginal/rektal për depistimin e infeksionit me streptokok beta-hemolitik.

### EKOGRAFIA OBSTETRIKALE E TREMUJORIT III

Ekografia obstetrikale e tremujorit III ka për qëllim vlerësimin e mirëqenies fetale (ritija, likidi amniotik, velocimetria Doppler), studimin e placentës (ekostruktura, lokalizimi etj.), paraqitjen e fetusit. Gjithash-tu ajo kryen edhe një studim

anatomik të fetusit (kuptohejo ja aq të detajuar sa ekografia morfologjike).

### NST (NON STRESS TEST)

Non-Stress test është një test i thjeshtë, joinvaziv që kryhet në shtatzënitë mbi 28 javë. Testi quhet "pa stres" sepse gjatë tij nuk ushrohet asnjë stres mbi fetusin. Testi kryhet duke vendosur një brez në barkun e nënës për të matur rrahjet e zembrës së fetusit dhe një tjetër brez për të matur kontraksionet e mitrës. Lëvizja, rrahjet e zembrës dhe "reagimi" i rrahjeve të zembrës ndaj lëvizjes apo kontraksioneve maten për 20-30 minuta. Një rezultat reaktiv në NST tregon se qarkullimi i gjakut (dhe oksigjenimi) në fetus është i mjaftueshëm. Një rezultat joreaktiv duhet interpretuar në kontekst me ekzaminimet e tjera dhe mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve nga ana e mjekut obstetër.



# Këshilla

## 9 gabimet që shpejtojnë procesin e plakjes

Janë pikërisht zgjedhjet që bëjmë çdo ditë që mund të çojnë në degradimin e trurit. Ushqyerja e keqe, duhanpirja, ekspozimi në diell dhe aktiviteti fizik luajnë një rol të fortë në jetëgjatësinë e njeriut, shkëlqimin e fytyrës së tij, plakjen e shëndetshme dhe funksionet e trurit. Sipas studimeve konfirmohet se të qenit mbipeshë ose obezë mund ta plakë trurin me të paktën 10 vjet. Ndaj nëse dëshironi të jetoni gjatë e të plakeni shëndetshëm kini kujdes nga këto gabime që po i listojmë më poshtë.

**NGRËNIA E MISHIT**  
Studimet kanë zbuluar një lidhje të fortë mes ngrënies së mishit dhe vdekjes së parakohshme. Ndërkohë, njerëzit që hanë më shumë fruta dhe perime kanë 15 për qind më pak gjasa të vdesin para kohë. Njerëzit që hanë mish janë më pak të prirur të hanë fruta dhe perime. Rrjedhimisht, ata marrin më pak antioksidantë dhe ushqyes të vlefshëm.

**JETA PASIVE**  
Të qëndruarit ulur për disa orë është shumë e rrezikshme. Të ulurit për të paktën 8 orë në ditë rrit rrezikun e vdekjes së parakohshme me 60 për qind. Ecja me një shpejtësi mesatare për të paktën një orë ul rrezikun e vdekjes së parakohshme me 40 për qind.

**EMBËLSIRAT DHE TË GAZUARAT**  
Pijet e gazuara dhe ëmbël-



sirat shkatërrojnë proteina të rëndësishme që janë përgjegjëse për paraqitjen rinore të lëkurës. Sheqerinat nxisin inflamacionin që është vatra e shumë sëmundjeve të rrezikshme.

**DRITHËRAT E BARDHA**  
Të gjitha drithërat me ngjyrë të bardhë nuk janë të pasur me fibër dhe ushqyes dhe në thelb janë një version ndryshe i sheqerit. Orizi i bardhë, buka e bardhë, makaronat, picat e të tjerë prishin ekuilibrat e baktereve në stomak.

Për një jetë më të gjatë duhet të zgjidhni drithëra me ngjyrë dhe përmbajtjen e tyre të plotë e natyrale.

**GJUMI**

Gjumi është një përbërës kritik i të gjithë rimëkëmbjes së organizmit. Mungesa e tij shkakton mbipeshë, depresion, diabet të tipit 2, tension të lartë të gjakut dhe sëmundje të zemrës.

**SHUMË PAK PESHK**

Peshqit janë ushqim i domosdoshëm për jetëgjatësinë. Ato janë të pasur me acide yndyrore omega-3 që luftojnë inflamacionin dhe

mbrojnë trurin. Gabimi i të mos ngrënit peshk rregullisht 2 herë në javë ju kushton disa vite jetë.

**STRESI, ALKOOLI DHE KAFJA**

Stresi rrit nivelet e kortizolit që ngadalëson metabolismin dhe nxit rritjen në peshë. Kafja nga ana tjetër ndërhyr jo vetëm në cilësinë e gjumit, por edhe në kohëzgjatjen e tij. Pirja e tepërt e alkoolit dhe e pijeve të tjerë të gazuara dëmton qelizat dhe zhbën punën e antioksidantëve. Yndyrat dhe të skuqurat

Yndyrat që gjenden tek margarina dhe produktet e skuqura e dehidratojnë lëkurën duke nxitur shfaqjen e rrudhave. Inflamacioni që shkaktojnë këto yndyra nxit shfaqjen e sëmundjeve koronare dhe diabetit. Të skuqurat nga ana tjetër nxisin praninë e radikaleve të lira në organizëm. Këto organizma janë fajtorë për plakjen jo të shëndetshme.

**EKSPOZIMI NË DI-ELL**

Ekspozimi i lartë dhe i pambrojtur në diell nxit jo vetëm rrudhat, por shkakton dëme të konsiderueshme në lëkurë dhe në paraqitjen tuaj. Konsumoni sa më shumë fruta dhe perime të stinës për të përfituar maksimalisht nga vlerat e tyre ushqyese dhe për të qëndruar të shëndetshëm gjithashtu.



## PERSHTYPJE NGA NJE UDHETIM

# Japonia e largët gjeografikisht, por e afërt me shqiptarët

Nga Genc Milloja

Shpesh këto kohë më ka rënë rasti që në biseda me miq, ni sur nga interesimi i tyre, t'u tregoj mbi çfarë kam parë, dëgjuar dhe mësova gjatë një vizite në Japoni në dhjetorin e vitit 2018. Reagimi i tyre ka qenë me të vërtetë tepër kureshtar, me shumë pyetje për atë vend aq të largët gjeografikisht nga Shqipëria, por i mirënjohur nga populli i saj. Veç admirimit për këtë "fat" timin, të bërë të mundur nga ambasada japoneze në Tiranë, që më mundësoi të vizitoja një botë tjetër të mbiquajtur "mrekullia japoneze", pyetjet kanë qenë të pafundme dhe nga më të ndryshmet. Por, në fakt nuk ka njeri në Shqipëri që nuk di për atë vend, por është e natyrshme që rrëfimet e një vizitori bëhen më të besueshme e interesante. Këtë ndjenjë e kam pasur edhe unë gjithmonë kur më ka rastisur të takoja njerëz që kishin qenë atje derisa zbrita në Tokio pas një fluturimi prej gati 13 orësh nga Stambolli. Nisja ishte Tirana dhe i gjatë ishte si fluturim, por ma kishin lehtësuar autoritetet japoneze, duke më vendosur në "business class", ku mosha ime e përballoi me sukses fluturimin Tiranë-Stambolli-Tokio në këtë vizitë, si pjesë e një grupi prej 6 gazetarësh nga vende të Ballkanit Perëndimor të ftuar nga Ministria e Jashtme e Japonisë. Pra, nga 3 deri më 13 dhjetor 2018 do të ishim bashkë përfaqësues të medias nga Bosnje-Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria në kuadër të iniciativës japoneze të bashkëpunimit ekonomik me Ballkanin Perëndimor.

Prezantimi i parë që në aeroport-perfeksionin dhe korrektesa në kohë. Çdo gjë ishte e kalkuluar si me kompjuter nga mbërritja, procedurat në aeroportin "Narita", pritja dhe deri të mbërritja në hotelin "Grand Palace", i cili ishte i vendosur në një zonë afër dikastereve qeveritare vendëse, gjë që ishte bërë për të lehtësuar lëvizjet tona në një metropol galaktik. Prej aeroportit rruga që zgjati gati dy orë për në hotel mu duk si vazhdim i fluturimit - i vje në qiell, se natën udhëtuam drejt Tokios dhe po yje shumëngjyrëshe vezëlues po shikoj në tokën japoneze. Filloi magjia japoneze për të cilën kisha dëgjuar aq shumë.

**RESPEKTI JAPONEZ NUK**



Mostrat e dy bombave të hedhura mbi Hiroshima e Nagasaki

### ËSHTË FASADË

Nëpër filma e kam parë atë përkuljen tradicionale japoneze në shenjë respekti në takime edhe të zakonshme, por kur e pash vetë, e kuptova se ishte plot sinqeritet dhe respekt, aspak e shtirur. Një ritual si me të huajt, por edhe me njerëz tjetrin. Tamam një shprehje e përzemërt respekti, çka më ngjason me atë përqafimin kokë më kokë të shqiptarëve në kohë të mëparshme. Ai ritual respekti na shoqëroi kudo në vizita në institucione qeveritare, shkencore, arsimore, kulturore deri në jetën e përditshme, ku ishim thjesht qytetarë europianë. Japonëzët kishin shumë respekt për europianët dhe madje aq sa takova, dinin për Ballkanin, sikurse edhe për Shqipërinë, në ndryshim nga shumë vende të tjera në Europë apo SHBA. "Japonia mbështet Europën e bashkuar dhe të fortë, e cila ndan vlerat themelore të Japonisë: shteti ligjor, liria dhe tregu i lirë. Në këtë kuptim ne shpresojmë shumë dhe mendojmë se shteti e Ballkanit Perëndimor duan stabilitet dhe zhvillim si anëtarë të fortë të Europës. Nisur nga kjo pikëpamje, Japonia dëshiron shumë të mbështesë reformat ekonomike dhe sociale të shteteve të Ballkanit Perëndimor, me synimin që t'i bashkohet BE-së", deklaroi në një takim ambasadori i ngarkuar për Ballkanin Perëndimor dhe zëvendës drejtor i përgjithshëm i Byrosë për Çështjet Europiane në Ministrinë e Jashtme, Jun Saito. Kryeministri japonez, Shinzo Abe, ka shpallur iniciativën japoneze për Ballkanin Perën-

dimor gjatë një turneu në disa vende të rajonit në janar të vitit 2018.

Unë e pyeta z. Saito se përse Japonia, ky vend i fuqishëm, është disa i vonuar sa i përket një iniciative të tillë në krahasim me fuqi të tjera dhe ai më tha se në fakt Japonia ndodhet në Azi dhe ndihmat i ka drejtuar kryesisht nga Afrika. "Europa është kujdesur për rajonin tuaj. Ne kemi shumë punë në rajonin tonë. Kështu që është dashur kohë për këtë iniciativë, por ja që ajo ndodhi kur ne pamë se Europa është disa e tronditur dhe ne menduam se na duhej të lëvizim. Ne duam një Europë të fortë dhe të bashkuar dhe në këtë kuptim mendojmë se mund të jemi në rajonin tuaj për të realizuar këtë Europë të fortë dhe të bashkuar".

Gjatë një takimi në Ministrinë e Jashtme, zj. Eriko Nakano, zëvendës drejtoreshë dhe Degës së Shtypit Ndërkombëtar si dhe funksionarët që mbulonin vendet përkatëse të rajonit shpjeguan hollësisht dëshirën e Japonisë për të rritur bashkëpunimin me rajonin. Në atë rast unë mësova në tempullin e diplomacisë japoneze se niveli politik imarrëdhënies midis Japonisë dhe Shqipërisë konsideroheshin shumë të mira dhe se Tokio dëshironte t'i zhvillonte më tej këto lidhje. Por, dukej qartë se rëndësi përparësore i kushtonin bashkëpunimit ekonomik. "Shqipëria shikohet nga Japonia si një ndër vendet kyçe në rajon dhe dëshiron të japë ndihmë në fusha të ndryshme si të ambientit, arsimit dhe shëndetësisë", tha zj. Nakano. Sa u përket investi-

meve, u tha se biznesmenët japonezë donin të dinin më shumë detaje për mundësitë e investimeve në Shqipëri. Dhe në këtë kuadër gjatë kohës që ishim atje, u zhvillua një seminar me përfaqësues të biznesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të atyre të Japonisë, ku përfaqësohet për Europën Qendrore dhe Jugore, Kotaro Otsuki, tha në seminar se rajoni i Ballkanit Perëndimor është në situatën e vet më të mirë, sepse të gjitha vendet e tij janë në rrugë e sipër drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ai tha se kompani japoneze kanë hyrë tashmë në këtë treg që popullohet prej 18 milionë banorësh dhe seminari ishte hap i parë konkret për bashkëpunim midis Japonisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sekretari i Përgjithshëm i Forumit të Dhomës së Investimeve të Gjashtë Vendeve të Ballkanit Perëndimor, Safet Gerxhalliu deklaroi në fjalën e tij se, "ne kemi pasur një të kaluar, kemi një të tashme dhe një të ardhme sa i përket bashkëpunimit me Japoninë". Por, një takim në selinë e Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) na dha mundësinë të mësonim konkretisht për projektet e realizuara dhe objektivat për të ardhmen të ndihmës japoneze për rajonin e Shqipërinë.

### "TREGOJANI JAPONEZËVE MREKULLINË SHQIPTARE!"

"Unë vërej se marrëdhëniet japonezo-shqiptare janë gjallëruar që prej vendosjes së ambasadës sonë në Tiranë. Ambasadori ynë, Makoito Ito, po punon shumë për të forcuar urrat e bashkëpunimit midis dy vendeve", tha në një intervistë ekskluzive që pata me z. Kotaro Otsuki, drejtor i Departamentit të Europës Qendrore dhe Juglindore në Ministrinë e Jashtme. "Marrëdhëniet midis Japonisë dhe Shqipërisë janë shumë të mira, por ne duhet të bëjmë shumë përpjekje për t'i zhvilluar ato. Ju keni nevojë për bashkëpunimin tonë dhe ne kemi nevojë për bashkëpunimin tuaj. Kështu që duhet të punojmë së bashku për t'i nxitur lidhjet tona të dyanshme". Shumë optimist ishte diplomati i lartë japonez për zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e turizmit. "Tregojani mrekullinë shqiptare japonezëve", ishte si thirrje nga ana e tij. Mu ngulit fort përshlytja jo vetëm nga kjo bisedë, por në përgjithësi se japonezët kërkonin projekte konkrete. Meza shihte i sinqertë kur thoshin:




Hiroshima pas "A-bomb"


"Hajdeni ju në Tokio ose vijmë në Tiranë, por me projekte konkrete, jo vizitë për vizitë". Duke ju përgjigjur një pyetje lidhur me qëndrimin e Japonisë për idenë e "korrjimit të kufijve" midis Kosovës dhe Serbisë, z. Otsuki tha se vendi i tij mbështet dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës të ndërmjetësuar nga BE. "Ne do të mbështesim rezultatin e dialogut nëse mirëpritet nga komuniteti ndërkombëtar dhe të dyja palët bien dakord. Ky është qëndrimi zyrtar japonez mbi problemin e "korrjimit të kufijve" midis këtyre dy vendeve". Z. Otsuki e kishte vizituar Shqipërinë dhe përshlytje të tij i përmblodhi me këto fjalë: "Unë kam qenë në Shqipëri dhe kam vizituar Elbasanin, Pogradecin, Tiranën, Gjirokastrën, Butrintin dhe Sarandën. Kështu që ju duhet t'i prezantoni popullit japonez ato vende mrekullisht të bukura".

### HIROSHIMA: 6 GUSHT 1945-10 DHJETOR 2018

Vizita në qytetin e Hiroshimës ishte etapa fundit e vizitës në Japoni, pasi kaluam dy ditë të mrekullueshme në qytetin historik të Kiotos, dikur kryeqytet i atij vendi. E kur po afroheshim në Hiroshima me trenin e shpejtësisë së lartë, i mbiquajtur "treni plumb", një prej kolegëve ballkanas më konfeso: "Se si ndjehem, shumë ligisht kur mendoj për ballafaqimin me ato që do të shikojmë në muzeumin kush-tarë kësaj tragjedie të paparë njerëzore". Bisedës iu bashkua shoqëruarë ynë në këtë turne, z. Atsushi Takahashi, një njeri që mund ta konsideroj perfeksionin e punonjësit publik japonez, i cili i tha kolegut tim boshnjak me shumë përkujdesje se mund të mos vinte në muze, çka gjeti kundërshtimin e menjëhershëm të tij. Mendova se Bosnja i ka më të freskëta krimet monstruoze të kryera në atë tokë kur po shpërbëhej Jugosllavia. Nga Kioto mbërritëm natën vonë në Hiroshima, i cili na e merrte magjishëm me gratacielat që duket sikur donin të kapnin qiellin, i cili ishte fort i kthjellët në atë natë të ftohtë. Kish-të ndryshuar moti, se ishte si pranverë kur mbërritëm në Tokio. E po mendoja duke shkuar në hotelin "Sunroute Hiroshima" se prej këtyri qielli, në një mëngjes plot dielli më 6 gusht 1945, në ora 8:16 bomba atomike (A-bomb) do ta rrafshonte këtë qytet. Muzeumi Përkujtimor i Paqes i Hiroshimës ishte farë pranë



Me Yasushi Akashi në Tokio



Embijetuara në Hiroshima

hotelit ku ishim vendosur dhe duke shkuar atje të nesërmen, askush nga grupi ynë nuk fliste, saqë na dukej sikur ajo bombë e mbiquajtur "Little Boy" na kishte përfshirë në mendime edhe ne. Në muzeum i pamë mostrat ose më mirë me thënë monstrat që u hodhën njëra pas tjetrës në Hiroshima dhe Nagasaki, e para me hidrogjen (Little Boy) dhe tjetra me plutoniumin (Fat Man). Të vogla në përmasa ishin, por pikërisht ato kishin shkakuar katastrofën e paparë njerëzore. Krijesa të mendjeve të mençura për vepra mizore, gjakatare. "Hiroshima dhe Nagasaki shërbejnë për të treguar jo vetëm fuqinë e armëve bërthamore, por mbi të gjitha vuajtjet dhe shkatërrimin barbar të njerëzve të pafajshëm", na tha zëvendësrejtori i muzeumit, Shuichi Kato, në fillim të një parakalimi fotografik të apokalipsit vrasar me emrin "Hiroshima". Bomba mbi qytetin e Nagasakit u hodh tri ditë më vonë, më 9 gusht 1945 dhe rreth 70.000 njerëz humbën jetën atje. Të gjithë kemi parë dokumentarë dhe filma për atë ngjarje në Hiroshima, por kur përballësh me çfarë kishte ndodhur atje, gati-gati tejkalohet çdo imagjinatë. Pamja e parë ishte një foto e madhe në datën 6 gusht 1945, ora 8:16 a.m. sipas orës japoneze dhe dukej sikur të paralarmëronte se po bëheshe dëshmitar i krimit më monstruz të njeriut kundër njeriut, kur bombarduesit amerikan B-29, i mbiquajtur Eno-la Gay, hodhi bombën e parë atomike mbi Hiroshima. "Është momenti i fillimit të një prej tragjediëve që mund të shkaktojnë armët bërthamore dhe Hiroshima ishte qyteti i parë në botë që pësoi krerë tmerri", tha Z. Kato dhe pas atyre fjalëve, një foto tjetër gjigante tregonte një qytet të zhdukur, ku men-

jëherë vdiqën rreth 80.000 njerëz numër që shkoi në 140.000 nga fundi i vitit 1945. Një video e ashtuquajtur "Panorama e Bardhë" në një minutë e gjysmë tregonte se si bomba "Djali i Vogël" (Little Boy) binte si rrufe mbi një qytet paqësor në atë orë kur banorët po shkonin në punë dhe fëmijët në kopshte e shkolla duke shkruaruar "zemrën e Hiroshimës". E nuk ishte më prekëse kur zëvendësrejtori i Muzeumit na ndaloi gjatë para një biçiklete me tri rrota të shkrumbuar. Biçikleta ishte e një djali trevjeçar, emri i të cilit ishte Shinichi Tetsutani. Ai po luante përballë shtëpisë së tij kur bomba shpërtheu dhe vala goditëse e shkruar mbante. Atë natë ai ndërroi jetë. Babai i tij duke menduar se i biri do të ndjehesh i vetmuar në varrin e tij, vendosi bashkë me të edhe biçikletën në kopshtin pranë shtëpisë. Kur eshtrat e fëmijës u zhvarrosën që të preheshin në një varrezë publike, babai i fëmijës së ndërroi ia dhuroi biçikletën muzeumit. Para se të shkonim në takimin me të mbijetuarën e tragjedisë hiroshiane më është ngulitur në mendje një foto që tregonte një burrë gjysmë shtrirë në një rrugë në mes gërmadhëve, i cili më 7 gusht, një ditë pas tragjedisë, përpjeq të valëve të këmbës në tij të bardhë si flamur që t'u jepte kurajë bashkëqytetarëve të mbijetonin për të rindërtuar Hiroshimën e rrenuar. Një ditë më pas, ai kishte vdekur me "flamurin e bardhë" fort në gjoks. "Hiroshima është puna e një njeriu, lufta është shkatërrim i jetës njerëzore, të kujtosh të kaluarën është dedikim ndaj së ardhmes, të kujtosh Hiroshimën është të urresh luftën bërthamore, të kujtosh Hiroshimën është të dedikosh veten ndaj paqes". Këto ishin fjalët që Papa Gjon Pali II, polaku i

ndjerë, Karol Jozef Wojtyła? kishte shkruar në përkushtimin e tij për viktimat kur ai kishte vizituar Muzeumin e Hiroshimës më 25 shkurt të vitit 1981. Të gjithë emrat e viktimave tek 'A-bomb', që humbën jetën atë ditë dhe më pas, janë të gdhendur në monumentin e Parkut Përkujtimor të Paqes së Hiroshimës dhe numri ishte 340.118 në ditën që ishim ne. "Çdo vit zgjatet kjo listë se i shtohen emra të rinj në çdo përvjetor. 'A-bomb' vrau dhe gjymtoi një numër të madh njerëzish, por ajo gjithashtu kalënduar brezat e mëvonshëm kur mësuam mbi viktimat, vuajtjet e të afërmeve të tyre - të popullit japonez", e përfundoi prezantimin e tij Z. Kato.

**TREGIMET E NJË TË MBIJETUARË**

"Kur ndodhi shpërthimi, ne ishim në klasë dhe nuk ia kishim idenë çfarë po ndodhte, vetëm se dëgjuam një zhurmë të fuqishme dhe të gjithë u shtrinë në tokë". Me këto fjalë e filloi tregimin e saj e mbijetuarja e tragjedisë së Hiroshimës, Katsuko Kuemoto, të cilën e takuam fill pas vizitës në muzeum. Kishte qenë 8 vjeç, në klasë të parë, kurse e motra dy vjet më e madhe, 8 vjeç. Ajo tregoi se të gjitha ndërtesat në të ashtuquajturën zonë e kuqe u shkatërruan, kurse ato në zonën e verdhë shpëtuuan pa u dëmtuar. Çdo gjë ajo e tregonte me hartë, duke mbajtur në dorë librin që kishte shkruar për kalvarin e saj, të popullit japonez. Dy motrat të ndihmuara nga të afërmit e tyre kërkonin nënën, se babai i tyre ishte ku ata nuk e dinin në atë kohë. Ja si e përshkruan përpjekjen e parë të kërkimit të nënës: "Ndërsa ecnim prej shtëpisë se xhaxhait, pas 500 metrash na doli përpara një fushë e mbushur me kufoma. Trupat ishin të mbuluar nga një fermer, por ne duhej t'i zbulonim në kërkim të nënës. Gushitë ishin me mot të ngrohtë dhe mund ta imagjinoni... Nuk mundëm të vazhdonim më. Trupat ishin shpërfytyrues, të gjithë kishin bërë përpjekje të iknin nga "syri" i bombës, por pa fat se kishin humbur jetën pas pak momentesh. Para se të vdiste një studente, e cila punonte në qytet, u kishte thënë se kishte parë një top të bukur stërmadh prej zjarri, i cili binte mbi Hiroshima. Një tjetër viktimë u kishte thënë se nuk e përshkruante dot ngjyrën e flakës. Por tashmë dihet se temperatura në tokë kishte arritur 4000 gradë celsius". E mbijetuarja Kuwamoto tregonte se e kishin gjetur nënën, e cila kishte jetuar edhe 15 vite, por në një gjendje shëndetësore të rëndë të përpjekjes shpeshme.

Babai i saj ishte kthyer nga ushtria. Askush në Hiroshima nuk e dinin se ishin goditur nga radiacioni i 'A-bomb', gjë që është mësuar pas 50 vitesh. "Në spital e dinin lidhjen midis bombës atomike dhe sëmundjeve, por personeli nuk ua tregonte pacientëve këto gjëra", konfesoji ajo. A ishte ajo e zemëruar me amerikanët që hodhën bombën? Përgjigja: "Unë nuk mendoj se amerikanët bënë gjënë e duhur, por duhet të pranohet se Perandori japonez e nisi luftën. Kështu që nuk jemi të mërzitur me vendet e tjera. Shumë amerikanë kanë dëgjuar konfesionet e mia. Por nuk tregojnë asnjë shenjë pendese. Edhe nipave e mbesave u tregoi nganjëherë për atë ngjarje. Por mund t'ju them se nuk e kuptoj çfarë ndjehem". Ne u larguam natën nga Hiroshima, më 10 dhjetor, me mbresa për çfarë pamë, dëgjuam dhe ndjemë, por të gjithëve na shoqëronte thirrja që dilte nga popullsia prej 1.196.274 banorësh e atij qyteti: "Kurrë më!". **YASUSHI AKASHI: "UNË JAM GJKATËSI I VEPRIMEVE TË MIA!"**

Personalisht e konsideroj veten me fat që në programin e vizitës ishte përfshirë një takim me figurën e mirënjohur politike botërore Yasushi Akashi, ish-përfaqësues i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për ish-Jugosllavinë në kohën e luftës në Bosnjë. Aq më shumë më shtoi kënaqësia se diplomatin veteran japonez Z. Akashi, i cili tash është 88 vjeç dhe ishte në një formë të mirë shëndetësore, kam pasur rastin ta ndjek në OKB si Zëvendëssekretar i Përgjithshëm i OKB-së kur isha me punë atje si këshilltar pranë Misionit shqiptar në Kombet e Bashkuara në Nju Jork nga 1987 deri në fund të vitit 1991. "Unë jam gjykatësi i veprimeve të mia"! Ky ishte mesazhi që Z. Akashi na dha në konfesionet e tij lidhur me veprimtarinë e tij diplomatike si dhe për ngjarjet e përgjakshme në Srebrenicë të Bosnjës në vitet 1990 dhe shumë konflikte të tjera ku kishte qenë me mision i ngarkuar nga Kombet e Bashkuara. Diplomati veteran japonez u caktua nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në janar të vitit 1994 si përfaqësues i posaçëm gati dy vjet pas shpërthimit të luftës në Bosnjë dhe qëndroi atje deri në 1995. Masakra e Srebrenicës ngjau në korrik të 1995, ku më shumë se 8000 boshnjakë, shumica burra dhe djem, u masakruan barbarisht nga serbo-boshnjakët. "Të gjithë palët kryen krime gjatë luftës së Bosnjës, por serbët janë përgjegjës për krimet më çnjerëzore në Srebrenicë nga serbët bosh-

njakë", tha Z. Akashi, i cili e quajti atë si një nga ngjarjet më të trishtueshme që kishte përjetuar. Por, sipas tij, forcat e OKB-së ishin pak në numër, pa ushqim dhe madje pa karburant që të vlin në lëvizje tanket e mjetet e tjera. "Askush nuk e priste që serbët do të arrinin në atë pikë sa që sulmonin Srebrenicën. E kujtoj kur komandanti im i OKB-së kërkoi për mbështetje ajrore nga NATO dhe e miratova brenda 10 minutash. Por më vonë u njoftova se bombardimet ishin afruar pranë trupave holandeze dhe pati një kërkesë për t'i ndaluar ata. Mu desh që kështu të veproja". Duke folur për të ardhmen e Bosnjës, ai shpresonte se nuk do të kishte luftë tjetër dhe shpresonte shumë tek të brezi i ri. Diplomati japonez e kishte admiruar Titon, kurse për pasuesit e tjerë të ish-Jugosllavisë mendonte se kishte ndryshime të mëdha të miratimit. Sipas tij, udhëheqësi serb, Slobodan Millosheviç, ishte më inteligjent se të tjerët dhe kishte dëshirë të dëgjonte. "Por duket ai ka pasur vizion dhe iluzionet e tij... Mënyra si zgjodhi njerëzit rreth tij ishte e gabuar. Ai nuk arriti të ndalonte histerinë e serbëve ndaj Kosovës". Z. Akashi iu kërkuar të shkonte në Hagë kur u gjykuan Karagjiç dhe Mladiç. "Shkova dhe dëshmova sikurse i kam përjetuar ngjarjet", tha ai. Sa i përket çështjes së "korrigjimit të kufijve" midis Serbisë dhe Kosovës, ai dha një përgjigje evazive. "Çdo gjë më duket si harxhim kohe, mendimesh dhe nganjëherë gjak. Nuk ia vlen. Bisedimet janë rruga e vetme. Beogradi dhe Prishtina duhet të vazhdojnë të dialogojnë".

**"KINA NUK ËSHTË MISHËRIMI I SË KEQES"**

I pyetur mbi praninë ekonomike në rritje të Kinës në Ballkan, Z. Akashi mendonte se iniciativa 16+1 vlen për zhvillimin e vendeve të rajonit dhe duhet shfrytëzuar avantazhi. "Unë mendoj se Kina nuk është mishërimi i së keqes. Unë kam qenë në Kinë shumë herë. Në Japoni ka njerëz që e ekzagjerojnë influencën e ardhshme të Kinës në vendin tonë... Meqenëse e kam parë Kinën me sytë e mi, ajo ka disa pika të forta, por edhe dobësi. Por populli kinez është shumë inteligjent", tha ai duke vlerësuar rolin e atij vendi në Afrikë. Sipas tij, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar nuk janë gjithënjë në një linjë me dëshirat e Kinës, por ai mendonte se ata janë nganjëherë arrogantë dhe të paarsyeshëm. "Unë mendoj se populli kinez është shumë inteligjent për të mos lejuar rikthimin e diktaturës".

**A MUND TË KISHTE MARRË ÇMIMIN NOBEL TË PAQES PËR ROLIN E TIJ NË KAMBOXHIA.**

Ja përgjigja e z. Akashi: "Një mik nga Singapori më tha se mund të kisha marrë çmimin Nobel të Paqes për punën e bërë në Kamboxhia, por ju shkua në Ballkan ku nuk ishit aq i suksesshëm. E përgjigja ime ishte se kur jeni zyrtar i OKB-së, nuk ka rrugë tjetër. Unë nuk mund ta kundërshtoja një detyrë të vështirë. Nuk kam asnjë pendesë që u angazhova në Ballkan. Ndoshta jam budalla. Por çmimi Nobel i Paqes çfarë është? Disa njerëz e marrin për meritat e tyre, disa të tjerë e marrin gabimisht. Por, unë jam gjykatësi i vetëm i veprimeve të mia".

Opinion i Ditës


# Kiço Blushi ishte një mik i veçantë dhe një shkrimtar i madh

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

... edhe tepër e dhimbshme. Kemi qenë miq të mirë dhe të vërtetë. Miqësia jonë u lidh qysh në vitet studentore. Kiço Blushi hyri në letërsi si një poet i vërtetë dhe shumë premtues. E kam dashur dhe e kam vlerësuar gjithmonë jo vetëm për thjeshtësinë e tij të veçantë dhe jo vetëm për vlerat njerëzore, por edhe për vlerat veçanta krijuese. Qysh në leximin e poezive të tij të para, unë kam parë tek Blushi që kisha të bëja me një poet të vërtetë. Vitet që do pasonin do ma përforconin edhe më tepër këtë ide.

Unë kam pasur shumë miq, poetë dhe shkrimtarë që kanë ikur nga kjo botë, por ikja e Blushit ishte tronditëse, pasi ka ca krijues si Kiço Blushi, ku pasqyroheshim më së miri të gjitha ato cilësi që e dallojnë një njeri dhe një shkrimtar të vërtetë nga grumbulli i shkrimtarëve të tjerë. Ka qenë një rastësi e këndshme që unë, para se të njihesha me poetin Kiço Blushi, në ca rrethana të çuditshme, jam njohur me të atin e tij. Ishte shofer. Njeri i thjeshtë. Atëherë isha student dhe ma kish të dhënë truri të shkoja në Korçë për t'u takuar me një vajzë, me të cilën kishim vetëm shkëmbim letrash. I zgjata dorën makinës së parë me targë Kr. Siç do ta merrja vesh atë mbrëmje, shoferi ishte babai i Kiço Blushit. Ai më tha të hipja në karroceri, pasi dy vendet e kabinës i kishte të zëna me dy pasagjerë që do të zbrisnin në Prrenjas. Më pas unë zura vend në kabinë, pranë shoferit. Nata dhe bora na zuri në Qafë-Thanë... I ati i Kiços ishte fjalëpak. Zbritëm të dy dhe ndezëm një zjarr në deborë... Atje ai më tregoi që kish të një djalë në moshën time që shkruante vjersha... Në atë shtator Kiço Blushi erdhi në fakultetin tonë dhe u regjistrua në degën e rusishtes. Qysh kur e pashë, më la një mbresë të mirë. I qetë, i mençur, biond, sykaltër... I ngjante Sergei



Eseninit, të cilin në ato vite ne e donim aq shumë. Unë, Musai, Ruzhdiu, Vathi ishim në vit të katërt, por Kiçon e futëm në miqësinë tonë... Ai shkruante shumë. Shkruante poezi me vargje të lira. Tematika e disa poezive të tij më kanë mbetur në mend. Qysh në njohjen e parë unë kam menduar që Kiço Blushi do bëhej një poet i madh. Vërtet nuk u bë poet i madh, por, them se me romanet e tij dhe me tregimet e tij u bë vërtet një shkrimtar i madh dhe i vërtetë... Për të gjithë ata që nuk e kanë njohur krijimtarinë e tij e që përmendin vetëm disa nga skenarët e tij, apo e njohin Blushin si publicist, unë dua t'u them se Kiço Blushi na ka lënë një krijimtarë të bollshme dhe të pasur letrare. Për me tepër, ai na la një letërsi të një niveli të

lartë cilësor. E cila renditet në krijimtarinë më të mirë të këtij pesëdhjetëvjeçari.

E veçanta e krijimtarisë së tij është krijimi i karaktereve të spikatura, jetësore. Personazhe të qëntuara nga jeta. Kiço Blushi nuk ishte një shkrimtar qyteti, jeta e tij e gjatë si gazetar, por edhe si skenarist, e kishte kushtëzuar që ai në lëvizjet e shumta nëpër Shqipëri të mbeshej me mbresa nga jeta... Ngjarje, tipa karaktere. Letërsia e Kiço Blushit mban aromën e një Shqipërie, të atyre viteve të vështira, të cilat kanë lënë gjurmë në jetën tonë, në krijimtarinë e tij dhe tashmë janë bërë pronë e letërsisë shqipe... Nuk rri pa kujtuar morinë e personazheve të marra nga jeta e tij si punëtor në Hidrocentralin e Vaut të Dejës.

Të përshkruar aq bukur dhe me aq realizëm në romanin e tij. E tillë ishte dhe Lezja, shoferja malësore e dhënë mjeshhtërisht tek drama "Lezja", vënë në skenë nga trupa e Teatrit të Korçës. Mund të përmendje dhe shumë tregime të këtij autori, të cilat mund të futen denjësisht në një antologji të tregimit më të mirë të letërsisë shqiptare. I tillë është romani që nuk mund të harrohet "Koka e prerë e Ali Pashës", por edhe romani tjetër edhe më i rëndësishëm, i cili u bë edhe film, "Beni ecën vetë". Kiço ishte një shkrimtar vëzhgimtar dhe modest. Atij nuk i pëlqente buja, as titujt si "Artist i merituar" apo "Mjeshtër i madh". Ai ishte i vetëdijshëm për talentin e vet dhe për krijimtarinë e vet... Të paharruar do të mbeten më kujtesën e të gjithë shqiptarëve

filmat "Beni ecën vetë" dhe "Në shëpinë tonë", me regji të Dh.Anagnostit. Shkrimtari Kiço Blushi ishte njohës i mirë i jetës dhe i personazheve që ka përshkruar në librat e veta. Mbi të gjitha, ai bënte një krijimtarë realiste të vërtetë dhe afatgjatë. Ai i përkiste racës së shkrimtarëve si Turgenievi dhe Çehovi, Mopasani dhe Cvajku.

Mbi të gjitha, Blushi ishte edhe një mik i mirë. Mund ta quajme me plot gojën një mik i heshtur, një mik i mençur, një mik nga i cili mund të përfitoje jo vetëm nga talenti i tij dhe eksperiencia e vet jetësore, por nga batutat e tij plot humor, që shpërndante me kurimsim në shoqërinë e tij të ngushtë... Te Kiço Blushi mik e bashkëmoshatar unë shihja njeriun si duhet të jetë dhe shkrimtarin model, krijuesin e thjeshtë, të mençur dhe me vizion, një shkrimtar i cili duhet të imitohet nga brezat që vijnë.

Vitet e fundit takimet tona kanë qenë të rralla. Ai fliste pak, por prekte gjëra esenciale. Shkruante pak, kryesisht publicistikë, por prekte probleme esenciale... Kur mora vesh sëmundjen e tij u trishtova shumë, mirëpo duke parë natyrën e tij të qetë, të përzemërt dhe optimiste, mendova se ikja e tij do të vinte në ditë të largët. Dita e ikjes së tij nuk ishte e largët, por të tashmë na ngushëllon ideja se shkrimtarët e vërtetë si Kiço Blushi nuk ikin. Jeta e tyre mund të jetë e shkurtër, por arti i tyre do të jetë afatgjatë. Ditët që jetojmë janë antiart dhe antiletërsi. Në ditët që jetojmë populli ka probleme ekonomike. Letërsia dhe arti në këto tri dekada ka një rënie të madhe interesi. Mirëpo unë mendoj se do të vijë një ditë kur krijimtaria e Kiço Blushit për vetë vlerat e saj të veçanta do të vendoset në panteonin e letërsisë më të mirë shqiptare. Nuk iku shkrimtari i madh dhe Kiço Blushi shkrimtar, iku vetëm miku ynë i veçantë dhe i paharruar.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinion *i* Ditës

# Një nikoqir shteti po duket... gërmadhash

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... terezitësin e parasë publike, ndryshe ministrin e Jinancave. Pak ose aspak njihen ministrat e Financave shqiptare të viteve 1912-1939. Disa syresh kishin kulturë perëndimore për kohën dhe provuan të bënin mirë, me gjithë kushtet tejet të vështira të mungesës së informacionit dhe disiplinës financiare. Një ministër i qeverisë shqiptare në kohën e nazizmit gjerman (1943-1944), Sokrat Dodbiba njihet akoma edhe më pak. Megjithatë, e tregoi veten një nikoqir të mirë të shtetit të zaptuar shqiptar. Kundërshtoi dhe ia arriti të mos futej në tregun shqiptar marka e zhvlerësuar gjermane (gjë që ndodhi rëndom në shumë shtete të tjera të okupuara të Evropës), duke mos e përmbitur kështu sistemin e pagesave me franga ari, që kishte deri atëherë vendi ynë. Gjermanët i kërkuan qeverisë shqiptare 30 mijë franga ari kontribut për qëndrimin e ushtrisë gjermane tek ne në vit. Ende nuk dihet se si zoti Dodbiba arriti, ndoshta duke rrezikuar edhe kohën e tij, t'u jepte gjermanëve vetëm 5-6 mijë franga ari në vit. Një përkushtim të tillë ndaj interesave të shtetit shqiptar e shohim rrallë ose asnjëherë në ministrat e financave ose në kryetarët e komisionit të planit të shtetit të kohës së diktaturës komuniste, edhe pse nga kjo kohë kemi sërish shumë pak informacion objektiv. Spikat vetëm në nëntor 1996 kuraja e një ministri të Partisë Demokratike, Ridvan Bode, që ishte i vetmi që paralajmëroi për efektin shkatërrues të skemave piramidale. Një gjë të tillë nuk e bëri as edhe misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar që ishte në Tiranë po në nëntor 1996! Më vonë, i njëjti ministër ishte ndër arkitektët e drejtimin të shtetit me duar të pastra në vitet 2005-2007, kur u kursyen 2 miliardë dollarë nga miradmiristimi i taksave dhe kontrollit doganor kundër futjes së mallrave pa akcizë. Në vitet e mëvonshme ky ministër la shumë nga përkushtimi për paranë e të gjithëve, në këmbim të kapitalit vetjak në parti. Megjithatë, arriti të tereziste buxhetin e shtetit në vitet e krizës së fortë botërore financiare dhe ekonomike 2009-2012, ndërsa e lëshoi përfundimisht dorën në kataklizmën financiare të periudhës janar-gusht 2013. Mori në vitin 2009 edhe një kredi sindikale (nga dy banka ndërkombëtare njëherësh) prej 250 milionë eurosh. Kredi për të cilën e kallëzoi në Prokurori 5 vite më vonë një tjetër nikoqir i shtetit shqiptar, ish-bankieri më i mirë qendror që kishim, për t'u bërë në shtator 2013 ministër i Financave. Ky ministër mendonte se shtetit nga kredia sindikale e marrë shumë shtrenjtë



i ishte shkaktuar një humbje prej 60 milionë euro, edhe pse kredia u mor në periudhën më të vështirë për kredidhënien në tregjet ndërkombëtare. Ishte ministri që ndërtoi marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar për huan e butë trevjeçare prej 330 milionë euro, që arnoi dhe mbushi xhepat e shpura të buxhetit të shtetit dhe disiplinoi financat tona publike të dala nga binarët. Ishte mendja pas një projektligji për procedurat tona tatimore që do të përmirësonin ndjeshëm administrimin tonë të taksave, por që fatkeqësisht mbeti vetëm një projekt, pse të tjerë pas tij menduan vetëm si e si të kënaqin kompanitë vendëse mbizotëruese në disa tregje. Ishte drejtuesi që arriti që çmendurinë e koncesionit PPP të skanimit të kontenierëve në dogana ta ulte me 44 për qind, nga 39 euro në 22 euro për kamion, në pamundësi për ta anuluar. Ishte ai që, edhe pse në publik foli fjalë mbështetjeje, du-

het të ketë qenë së bashku me Fondin Monetar Ndërkombëtar, varmhësi i idesë tjetër të çmendur, që kishte kapluar kësaj radhe qeverinë ku bënte pjesë, të dhënies me koncesion PPP të mbledhjes së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH). Ku me një ofertë të pakërkuar, kompania e huaj private nga Hong-Kongu zotohej të mblidhte për vitin 2016 11 për qind TVSH më shumë, në një kohë kur vetë buxheti i shtetit kishte mbledhur për vitin 2015 13.7 për qind më shumë! Nikoqiri u largua, duke lënë... gërmadha. Pas tij, në tri vitet e fundit ka ndodhur kapja më e përbindshme e shtetit nga interesat e kompanive vendëse mbizotëruese në disa tregje. Koncesionet e dhëna me formulën e Partneritetit Publik-Privat (PPP-janë mbi 2.2 miliardë euro) dhe që kanë hyrë në xhepin tonë si qytetarë pagues taksash edhe për 10-15 vitet e ardhshëm, u shitën si alternativa të fuqishme dhe të guximshme investi-

mi të privatit, për të balancuar përfundimin e dy koncesioneve TAP dhe hidrocentraleve mbi lumin Devoll. Por ndërsa këto 1.7 miliardë euro investime vinin nga jashtë, kapitali tërësisht i huaj që i hynte vendit, këto 2.2 miliardë euro ne shqiptarët do i marrim këtu, nga brenda, nga bankat tona dhe do të na kushtojnë sa frëngu pulën! 360 milionë eurot e një prej këtyre çmendurive të reja u kthyen mbrapsht pak javë më parë. Dhe jo vetëm ekonomistët e ndershëm të këtit vendi, por edhe shumë qytetarë të thjeshtë e mendojnë se prapa kësaj sbrapseje qëndron dora e nikoqirit të ri të shtetit, i thirrur në një mision gati të pamundur në fund të dhjetorit 2018. Edhe pse nuk ka veshur kostumin e ministrit, si të tjerë përpara tij. Dhe shpresa ka nisur e po ngrihet se pas kiametit që na ndodhi, mund të kemi disa rimëkëmbje, rikuperim të interesit të lënduar rëndë publik, me kurajën dhe dijet e nikoqirit të ri.

## HOROSKOPI

### DASHI

Mos e humbni kohën tuaj të çmuar duke u përpjekur të ndryshoni sjelljen e një personi të bezdisshëm këtë mëngjes. Ruajeni energjinë për më vonë, nëse përballeni me ndonjë problem. Lajmi i mirë është se do të shihni dritë në fund të tunelit.

### DEMI

Nëse nuk e ndjeni veten në një linjë me miqtë tuaj, kjo nuk do të thotë se opinioni që ata kanë për ju nuk është pozitiv. Në aspektin financiar, mund të përballeni me probleme, nëse nuk tregoni kujdes maksimal me një investim.

### BINJAKET

Në këto momente mund ta dashuronin punën tuaj, por ka një dritë shumë të ndritshme që ndriçon në të ardhmen tuaj profesionale. Ju do të merrni atë që meritoni. Nuk ka arsye të ndihesh i pashpresë. Në të vërtetë keni çdo arsye të ndiheni shpresëplotë.

### GAFORJA

Energjia e mirë është jashtëzakonisht ngjitesë sot, kështu që nëse nuk ndjehesh mirë me njerëzit që ju rrethojnë, bëj një ndryshim. Në dashuri parashikohen disa zhvillime pozitive që do ju bëjnë të buzëqeshni.

### LUANI

Do të jetë një ditë shumë e mirë për ju, veçanërisht nëse shmangni ndonjë marrëdhënie financiare me të tjerët. Shkëmbimi i parave ose investimi i parave nuk do të ishte diçka e zgjuar sot. Prisi derisa të bëni hulumtimet e duhura.

### VIRGJERESHA

Ju keni një shpirt shumë bujar dhe njiheni si person që është gjithmonë aty për të ofruar ndihmë. Dikush i afërt me ju nuk po arrin potencialin e tij dhe ju takon që të bëni diçka për këtë. Mos jini shumë kritik, thjesht ofroni disa këshilla.

### PESHORJA

Bëhuni gati që rutina juaj e përditshme të prishet, por për mirë. Ekziston një surprizë emocionuese që po vjen shpejt dhe do të shtyjë disa nga planet tuaja. Përpunoni të jeni fleksibël në disa projekte.

### AKREPI

Të kesh romancë në jetën tënde nuk do të thotë thjesht të jesh i dashuruar. Të jesh romantik thjesht do të thotë të kënaqesh duke parë gjërat në një mënyrë më ideale, të bukur dhe shpresëdhënëse. Investoni në lumturi dhe ajo do të kthehet të ju.

### SHIGJETARI

Energjia që do t'ju karakterizojë në mëngjes do t'ju bëjë që ta nisni ditën mbarë. Do të arrini të përmbushni disa obligime që i kishit lënë pas dorë. Mos humbni kohë, por shfrytëzoni këtë moment për të arritur qëllimet tuaja.

### BRICJAPI

Konkurrenca mund të jetë frikësuese sot, por ju keni një gjë që asnjë nga kundërshtarët tuaj nuk e ka, kreativitetin. Përdoreni atë në avantazhin tuaj dhe kurrë nuk do të zhgënjeheni.

### UJORI

Mos u tregoni shumë modest sot, por tregoni se për çfarë meritoni vlerësim. Në punë do të jeni i pakonkurrueshëm. Në dashuri, gjithçka do të shkojë në mënyrë perfekte, veçanërisht nëse tregoni durim.

### PESHQIT

Sot bota do të duket si një pasqyrë, sepse do të shihni pak nga të tjerët të çdo person me të cilin bashkëveproni. Ndjeshmëria juaj do të jetë maksimale, duke ju bërë më të hapur ndaj eksperiencave të reja.

**TRAJNERI I TIRANËS**

Trajnieri i Tiranës, Armando Mema, në intervistën në "Gol pas Goli" në "Supersport" pas fitores me Kukësin, deklaroi: "Trajnieri mendon të këqijat para të mirave, por patëm probleme në pjesën e dytë. Gjithsesi, është kthyer entuziazmi dhe kemi nisur me fitore. Nder Partizanit? Në ditët në vazhdim do i bëjmë nder edhe Kukësit, edhe ne do

**Mema: Nder Partizanit? Do t'i bëjmë nder edhe Kukësit!**



luajmë me Partizanin, mund të fitojmë edhe me ta. Pyetja e dytë është e vështirë ta them si kam vepruar. Janë harmonizuar veprimet në çifte dhe reparte. Ekipi ka kërkuar gjithë kohës ta fitojë ndeshjen. Nga rezultatet e këqija ka edhe uri për të fituar. Ne kemi vazhdimësinë tonë dhe duhet të shohim përpara".

**TRAJNERI I KUKËSIT**

Trajnieri i Kukësit, Armando Cungu, foli pas humbjes me Tiranën në "Gol pas Goli", në "Supersport", ku deklaroi: "Ndodhi ajo që po ndodh që në fillim të këtij sezoni të ri. Ekipi nuk po shfaqet me atë nivel si në dy fazat e para. Më shumë kemi folur për kampion, se sa kemi dhënë në fushë. Më shumë kemi dalë të parët me flamur për mediat dhe jo në fushë. Te Partizani kanë ndenjur më shumë me këmbë në tokë

**Cungu: Kemi dalë kampionë nëpër media, por jo në fushë!**



dhe kanë bërë më mirë se ne. Partizan luan para? Edhe kjo indirekt ndikon. Lojtarët e mendojnë se duhet fituar me çdo kusht, fitohet duke zbatuar detyrat në fushë. Kjo i sjell edhe presion. Unë kam mendimin që ekipet rivale duhet të luajnë në të njëjtën ditë dhe të njëjtin orar".

Doka ndëshkon verilindorët në një ndeshje të luftuar, ku bardheblutë befaskan shpenzimet milionere të rivalit

# Tirana frenon Kukësin dhe i jep asist Partizanit

*Përfitojnë të kuqtë, që shkëputen në +8 në krye*



Jeton Selimi

E pabesueshme ajo që në ndodhi në Kamëz, e vështirë të kuptosh se kush festoi më shumë pas humbjes së Kukësit, Tirana që sigurojë një trepikësh jetik për objektivat e tyre sezonale apo Partizani me të kuqtë, që e shohin veten tashmë plus tetë pikë nga verilindorët. Armando Cungu dhe ekipi i tij bëjnë "harakiri" në shtëpi. Jo vetëm që nuk arritën të çanin Tiranën, por një gol i Albi Dokës në minutën e 86-të i shkaktoi humbjen e 5-të sezonale në kampionat. Pas një fillimviti aspak pozitiv, Kukësi duket se rilindi në Vlorë me atë trepikësh, por Tirana e rikthen sërish me këmbë në tokë, duke i marrë pikë të plota. As Shkurtaj, as Rexhinaldo, as Rama nuk arrijnë të bëjnë diferencën. E kishin shumë të vështirë të ndëshkonin portierin Abibi, ndërsa kryeqytetasit i goditën me një dalje të shpejtë në sulm, një aksion të finalizuar nga Doka, që i jep Tiranës të drejtën për të synuar Europën edhe nga kampionati.

**PAQE NË GJIROKASTËR**

Topa të gjatë, faulle të shumtë dhe pak raste për shënim. Luftëtari-Flamurtari dhuroi pak futboll, me dy ekipet që e spostuan pjesën më të madhe të lojës në mesfushë, ku më shumë se sa të krijonin, u kujdesën të shkatërronin. Është e vështirë të gresh diçka të



bukur në këtë takim, por si gjithnjë nuk mungoi një rast për moviolë, me gjirokastritët që reklamuan për një penallti në minutën e 39-të, ku Pollozhani ndërhyri ndaj Filit. Në fund të dyja skuadrat ndanë nga një pikë pas barazimit 0-0, një "X" që as nuk kënaq, as nuk gëzon as-

një nga të dyja ekipet. Luftëtari ndjen presionin nga posthtë, ndërsa Flamurtari sheh që Europa largohet gjithnjë e më shumë.

**TEUTA, 11 METRA LARG FITORES**

Fitorja është një kujtim i largët në Durrës me Teutën, që nuk e njeh një shijë të

tillë që nga viti i shkuar. Tri barazime në tri ndeshjet e fundit zbehim jo pak atë shkëlqim, që bregdetarët kishin fituar në dy fazat e para. Merkato e bujshme duket se ka "trulllosur" idetë e Bledi Shkëmbit, i cili nuk po arrin ta rikthejë ekipin të paktën në nivelin që ishte në dy

SUPERLIGA		
JAVA E 21-të		
TE SHITUNEN		
Partizani - Kastrioti	2-0	
TE DIELEN		
Kukësi - Tirana	0-1	
Luftëtari - Flamurtari	0-0	
Teuta - Kamza	0-0	
TE DIELEN		
Skënderbeu - Laçi	18:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	21	46
Kukësi	21	38
Teuta	21	36
Laçi	20	31
Skënderbeu	20	30
Flamurtari	21	30
Tirana	21	24
Luftëtari	21	21
Kastrioti	21	16
Kamza	21	16

fazat e para. Pas Flamurtarit dhe Tiranës, është radha e Kamzës t'i marrë pikë dhe këtë ekipi i Ernest Gjokës e bëri jo duke u mbrojtur, por duke luajtur një 90-minutësh si të barabartë. Dukshëm Teuta ishte më dominuese, krijoi më shumë raste për shënim, por Kamza nuk "vodi" asgjë, përkundrazi krijoi disa raste për shënim, ku edhe një herë në 'apel' u thirr Isli Hidi. Rastin më të pastër të sfidës e shpërdori Sherif Kallaku, i cili gaboi nga pika e bardhë e penalltisë në minutën e 19-të. Teuta shtoi presionin në zonën e Kamzës, mbi të gjitha në pjesën e dytë ku Kamara, Latifi e Kallaku provuan me çdo formë për të zhblokuar takimin. Në fund të dyja skuadrat ndanë nga një pikë pas barazimit pa gola. Teuta nuk përfiton nga hapi fals i Kukësit, vijon të qëndrojë në vendin e tretë në kuotë në 36-të pikëve, ndërsa Kamza edhe pse me pikë të barabarta me Kastriotin, arrin t'i parakalojë duke u pozicionuar në vendin e 9-të me 16 pikë.

**SERIE A**

**Juventusit mposht Sasuolon dhe rikthehet në +11**

Juventusit ka marrë një fitore të pastër ndaj Sasuolos në transfertë me rezultatin 0-3. Kështu, bardhezinjtë e çojnë sërish në 11 pikë diferencën nga vendi i dytë, që mbahet nga Napoli. Ishte Kadir, ai që ka kaluar në epërsi bardhezinjtë në minutën e 23-të, pas një pritjeje të keqe të portierit. Në pjesën e dytë, Ronaldo me kokë dyfishon shifrat dhe Emre Çan në minutën e 86-të vulos gjithçka me një aksion fantastik të kampionëve të Italisë. Juventusit kështu ka hequr edhe një ndeshje tjetër në një transfertë jo të lehtë dhe ka bërë një diferencë, që do ta lërë disi më të qetë të luajë ndeshjet me Atletikon e Madridit në Ligën e Kampionëve.

**PREMIER LIGA**

**Siti luan tenis me Çelsin dhe kap Liverpuln**


Manchester Siti ka marrë një fitore të madhe ndaj Çel sitit me rezultatin e thellë 6-0. Ekipi i Guardiola's është treguar i pamëshirshëm dhe i pandalshëm në këtë derbi, që vetëm si i tillë nuk përfundoi. Pjesa e parë u mbyll në avantazhin e katër golave, që u shënuan në vetëm 25 minuta. Sterling, dy herë Agüero dhe Gündogan mbyllën "llogaritë" për 45 minutat e para. Pjesa e dytë nisi më të qetë nga "Qytetarët", të cilët shënuan edhe dy herë të tjera me Agüeron nga pika e bardhë e penalltisë dhe Sterling në minutat e fundit të sfidës. Tashmë Siti kap Liverpuln në vendin e parë me 65 pikë, por me një ndeshje më

**BUNDESLIGA**

**Shkëlqen Milot Rashica, dy gola kundër Augsburgut**

Milot Rashica vazhdon të tregojë se është një nga lojtarët më të mirë dhe më në formë në radhët e skuadrës së Verder Bremenit. Në sfidën e djeshme ndaj Augsburgut, sulmuesi i talentuar i përfaqësueses kosovare ka realizuar dopietë. Pikërisht në të 5 dhe 28. Verder Bremen ka fituar me rezultatin 3-0 ndaj Augsburgut dhe natyrisht që meritën kryesore e ka sulmuesi shqiptar. Me këtë fitore, skuadra e Bremenit ngjitet në kuotën e 30 pikëve dhe mban vendin e 10-të. Dopietë e djeshme ishte e para për këtë sezon dhe Rashica arrin në kuotën e shtatë golave, duke mbetur një pikë referimi në ofensivën e skuadrës gjermane.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstreme në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.

34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye yë evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremet në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

**VERTIKAL**

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjen për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibusterët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

**VERTIKAL**


35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i Iellëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstreme në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërоре
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimize
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lemper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

H	E	S	A	P	E	T	T	F	A	B	C	
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E	T
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T	
E	L	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T	
N	R	B	U	R	I	M	E	T	J	A		
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T	
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	A		
P	L	A	A	T	O	M	I	K	E	A		
A	N	S	T	E	R	E	O	L	T			
P	A	R	S	I	D	M	A	R	I	A		
A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	I	O	N
S	A	R	D	O	U	D	E	T	T	A		
P	A	R	A	G	R	A	F	I	V	A	N	
T	R	O	N	I	A	I	O	S	E	R	A	
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A		
A	M	E	T	L	E	M	A	K	U	L		
T	I	R	T	E	L	E	M	A	K	U	L	
V	S	K	A	P	O	N	A	R	I	N	A	
V	A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N
J	O	E	T	N	E	T	E	M	A			
R	I	M	A	T	R	A	D	E	T	I		
A	R	I	A	N	A	D	E	T	I	N	I	K
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C	E

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOK**

				7	8			
7		4		6				
8							4	2
			3		6		4	
1			2		8			9
5	3		7		8			
		2	1		3			9
		1	9					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	9	7	8	2	6	5	4	3
3	8	4	5	1	9	7	2	6
6	2	5	4	3	7	1	8	9
2	3	1	7	6	8	4	9	5
7	4	6	2	9	5	8	3	1
9	5	8	3	4	1	2	6	7
5	6	9	1	8	2	3	7	4
4	1	2	9	7	3	6	5	8
8	7	3	6	5	4	9	1	2

*Argëtim filozofik*

- Mos qaj për të shkuarën, mos ëndërro për të ardhmen, përqendro mendjen tek e tashmja (Buda)
- Mos i bëj të tjerëve atë që s'të pëlqen të ta bëjnë ty (Sokrati)
- Jeto sikur do vdesësh nesër, mëso sikur të duhet të jetosh gjithmonë (Mahatma Gandhi)
- Bëj punën që do, dhe nuk do të të duhet të punosh kurrë (Konfuçi)
- Mendoj, pra jam (René Descartes)
- Vdekja s'duhet të na shqetësojë pasi kur ne ekzistojmë vdekja nuk ekziston, dhe kur vdekja ekziston, ne s'do të jemi më (Epikuri)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1			
18	3	1	4		18	3	17	13	1			
8	1	10	10	10	1	3	1	6	12	6		
3	1	10	2	5	6	14	1	12	2	4		
13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2	4	
15	9	6	15	1	12	4	6	6	3	3		
17	2	4	5	12		2	14	17	5	1	4	
8	1	7	6		3	1	10	1		2		
15	5	12		4	6	4	18	7	7	1	3	
1	3	2	8		1	5			2	12	2	
20	19		1	3		20	5	4	6	10	2	4
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8	

C	R	A	L	K	I	M	I	S	T	I		
C	O	S	T	N	E	R	P	A	V			
I	L	R	M	I	I	K	L	A				
R	K	O	P	E	R	N	I	K	U	N		
K	O	O	P	E	R	A	T	I	V	A	T	
K	L	I	N	I	K	E	L	F				
T	R	O	K	E	I	R	O	N	I	K	E	
R	S	A	L	T	E	V	I	T	A			
I	T	A	L	I	A	S	E	E	V	A		
U	L	E	M	A	R	T	A	C				
M	A	E	J	E	A	N	L	I	J	A		
F	U	T	U	R	I	S	T	E	T	A	R	

*Thënie të mënçura*

- Shpata nuk vret njeri; ajo është mjet në duart e vrasësit (Seneka)
- Jeta është shumë e shkurtër për të shpenzuar kohën duke lexuar një libër të keq (James Joyce)
- Dobësia e sjelljes bëhet dobësi e karakterit (Albert Einstein)
- Ata që nuk mund të ndryshojnë mendjen e vet nuk mund të ndryshojnë asgjë (George Bernard Shaw)
- Nëse nuk ka Zot, çdo gjë është e lejuar (Fyodor Dostoyevsky)

